



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 24 korrik 2020, në mbledhjen e XXXIII (tridhjetë e tre), e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

E thirrur me kërkesë të 13 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç znj.Mrika Thaqi e cila mungoi (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe Drejtorët e Drejtorive (DKA, DSHMS, DKRS,DSHPMSH, DBPZHR,DA).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave dhe OJQ-së SDK dhe rrjetit lokal të OJQ-ve DFK.

Rendi i Ditës

➤ **Dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore nga vërshimet dhe breshëri**

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i'u dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë e cila gjithashtu po mbahet në kushte dhe masa jo të zakonshme për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Shtoi, konsideroj se thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, kjo seancë e jashtëzakonshme është thirrur me kërkesë të 13 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës me temën e caktuar nga vetë iniciuesi i kësaj mbledhje, dhe atë; *Dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore nga vërshimet dhe breshëri në Komunën e Podujevës.*

Sa i përket mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, jemi në dijeni se mbledhjet e jashtëzakonshme temat e caktuara nuk mund të ndryshohen apo plotësohen, andaj të gjithë jemi pajtuar që kjo mbledhje të mbahet, të debatohet dhe të jepet kontribut nga të gjithë.

Bartës i kësaj kërkesë ka qenë këshilltari z.Pajtim Hodolli, të cilit paraprakisht ja jap fjalën.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, unë si iniciues i kësaj seance të jashtëzakonshme fillimisht i falënderoi gjithë kolegët asamblist nga opozita të cilët kanë shprehur gatishmërinë për ta mbështetur iniciativën time duke dhënë nënshkrimet për thirrjen e kësaj mbledhje, për të trajtuar një temë shumë të rëndësishme e cila vije si kërkesë e fermerëve të vyeshëm Llapjan të cilët janë dëmtuar rëndë nga vërshimet dhe breshëri që ka ndodhur këtë vit e sidomos javën e kaluar. Qëllimi kryesor i thirrjes së kësaj seance është diskutimi dhe gjetja e zgjedhjes së problemeve të paraqitura pas dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe breshëri në disa lokalitete të Komunës së Podujevës me çka janë dëmtuar rëndë disa lloje të kulturave bujqësore siç janë; mjedra, boronica, specat, domatet, patatet, lakrat dhe kultura të tjera dhe është vështirësuar puna e fermerëve të vyeshëm Llapjan.

Diskutimi dhe gjetja e një zgjedhje që mundëson mbështetjen e fermerëve duke ia kompensuar dëmet e shkaktuara fatkeqësitë natyrore është e një rëndësie të madhe dhe një urgjencë e

menjëhershme për shumë arsye. Arsyeja kryesore është përgjegjësia institucionale për të qëndruar afër fermerëve dhe për t'i mbështetur ata të cilët duke punuar vet nuk bëhen barrë e shtetit dhe si sektor përfaqëson një numër të madh të të vetpunësuarve të cilët po nuk mbështeti shteti atëherë rrezikojnë të përfundojnë si kategori e skemave sociale dhe të rëndoi edhe më shumë nivelin e papunësisë dhe të thellojë varfërinë edhe ashtu të madhe në komunën tonë.

Arsye tjetër është fakti se viti 2020 nuk është vit i zakonshëm por është vit i jashtëzakonshëm për shkak të pandemisë Covid-19, dhe rënies së të hyrave në çdo ekonomi familjare, prandaj nuk guxojmë që edhe këtë burim mbijetese për shumë familje të mos e mbështesim, për fat të keq kemi shumë shembuj që komuna jonë vetëm nxit fermerët që të hyjnë në kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore dhe pastaj i braktis ata duke mos i mbështetur më tutje as në rastet e fatkeqësive natyrore e as në raste kur duhet të shitet produkti final. Ajo që kemi parë deri më tani nga institucionet komunale është se mbështetjen për sektorin e bujqësisë e trajtojnë si pjesë e fushatave elektorale për të siguruar mbështetje për vota dhe jo si sektor strategjik që është shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal. Fermerët janë shtresa më e sigurtë dhe në e e pastër e shoqërisë tonë prandaj edhe si të tillë duhet të trajtohen, fakti që fermerët jetojnë nga puna e tyre dhe jo nga tendero mania siç bënë stafi politikë drejtues i komunës tonë që 20 vite flet shumë dhe duhet t'i bëjë shumë të kujdesshëm kur flasim dhe veprojmë për fermerët tanë.

Gjatë këtyre ditëve kam vizituar disa lokalitete të prekura nga kjo fatkeqësi natyrore dhe kam pasur biseda të shumta me qytetarë, nga të cilët kam kuptuar se disa zyrtar komunal në disa vende kanë dalë në terren mirëpo ata thonë se edhe viteve të kaluara ka ndodhë e njëjta gjë por nuk është ndërmarrë diçka konkrete pas bisedave dhe premtimeve, pra nuk u është dalë në ndihmë qytetarëve vetëm u janë marrë shënime për dëmet e shkaktuara dhe asnjë kompensim nuk është bërë. Unë do të pyesja drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, në fakt kam disa pyetje e që shpresoj që do i shkruaj ai, dhe atë; -çfarë kuptimi ka ndarja e subvencioneve në emër të bujqësisë për bujqit e ri potencial kur bujqit aktiv tani nuk mbështeten dhe detyrohen ta lënë punën e bujqësisë, -si mund të arsyetohet një injorim kaq i madh për këtë sektor kur fermerët kanë punuar tërë vitin për ta fituar bukën e gojës dhe tani jo që nuk fitojnë diçka por futen edhe në borxhe për shkak të dëmeve dhe fatkeqësive natyrore kurse DBPZHR përveç marketingut politik që bënë nëpër fushata asgjë konkrete nuk bënë, -a keni mbështetur ndonjëherë ndonjë fermer në këto dy vitet e fundit pas dëmeve që u janë shkaktuar pas vërshimeve dhe breshërit në Komunën e Podujevës.

Jam dëshmitarë i skenave të turpshme të reklamave mbi subvencioneve që drejtuesit e komunës u bëjnë duke detyruar fermerët të rreshtohen në shesh për të bërë foto e për të bërë video para mjeteve bujqësore dhe të bëjnë foto me Kryetarin e Komunës për qëllime të fushatës thuajse ato mjete i shpërndan Kryetari i Komunës nga buxheti familjar e jo nga buxheti i taksave të qytetarëve, kjo gjë është e pa pranueshme. Mbështetja e fermerëve është obligim i Komunës prandaj drejtuesit e komunës nuk mund të sillen sikur këto mjete i kanë sjellë nga shtëpitë e tyre.

Unë si këshilltar i Kuvendit Komunal propozoi që Kuvendi i Komunës të formoi një komision i cili do ta mbikëqyrte punën e komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe të gjendet mundësia për tu dalë në ndihmë këtyre fermerëve duke ua kompensuar dëmet e shkaktuara. Është obligim i zyrtarëve përgjegjës për të gjetur fondet qysh nga niveli qendror apo nga niveli lokal, nuk është arsyetim mungesa e buxhetit për këtë kategori pasi është lehtë e planifikueshme sepse për çdo vit kemi problemin e njëjtë me dëme që shkaktohen nga vërshimet dhe nga breshëri.

Për fund kërkoj që t'i qasemi seriozisht këtij diskutimi, të mundohemi të lirohemi nga dallimet politike dhe të shohim se cila është zgjidhja reale për ta zgjedhur këtë problem pasi që fermerët nuk i takojnë as pozitës e as opozitës por na takojnë gjithë neve.

z.Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - DBPZHR, theksoi, të dashur fermer dhe bujq të Llapit, vërtetë gjendja e fermerëve Llapjanë është e rënduar unë me kënaqësi sot kam ardh këtu për t'iu informuar se dëmet në bujqësi kanë filluar nga 01 janari 2020 dhe kanë vazhduar deri më datën 18 korrik kur ishte vërshimi dhe breshëri i fundit, mirëpo kishte me qenë mirë nga të gjithë ne këtu që jemi mos te politizojmë situatën por të merrem direkt me fermerët dhe të gjejmë një zgjidhje që vërtetë do të ndikonte direkt te fermerët, kur kemi parasysh që fermerët janë shtresa më e veçantë e kësaj shoqërie të cilët po ndikojnë direkt në mirëqenien e qytetarit, në gjenerimin e vendeve të reja të punës po pse jo edhe në produktet bio që ne të gjithë që jemi këtu dhe gjithë qytetarët e Podujevës po i prekim dhe po i konsumojmë ato produkte.

Dëmet janë të konsiderueshme, unë qysh prej fillimit me ekipet komunale, me theks komisionin përkatës për vlerësimin e dëmeve i ngritur nga Kryetari i Komunës i cili përbëhet prej zyrtarëve të DBPZHR dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH gjithherë kemi dalë në terren dhe kemi qenë afër fermerëve, unë dëshiroj të ndalem vetëm në pika të shkurtra në mënyrë që t'iu lë hapësirë secilit prej juve që vërtetë të debatojmë rreth kësaj teme dhe që në fund të gjejmë ndonjë zgjidhje me qëllim që t'i ndihmojmë fermerët dhe mos ta politizojmë këtë çështje. Problemet me kushtet klimatike kanë filluar që nga 01 janari 2020, fillimisht me ngrica, mandej pas shfaqjes së pandemisë Covid-19 e që jeni në dijeni se kemi shumë fermerë të mëdhenj prodhues të cilët nuk dëshiroj t'i cekë me emra por që të cilët prodhimet e tyre siç janë, lakra, karrota, e të tjera prodhime tjera me qindra tonelata është dashur t'i hedhin në mbeturina e që vërtetë janë dëmtuar.

Mandej jeni në dijeni që poashtu kemi shumë fermerë kultivues të kulturave bujqësore në pranverën e hershme si, sallata e gjelbër në serra, të cilët vërtetë duhet falënderuar për një punë të mrekullueshme që bëjnë, por që atë sallatë që është dashur ta dërgojnë nëpër restorante të ndryshme, si pasojë e dëmeve është dashtë ta hedhin si mbeturinë.

Pastaj territorin e Komunës së Podujevës e ka përcjellë një mot me kushte klimatike me vërshime, breshër e që më 18 korrik të këtij muaji kemi marrë një goditje të madhe ku disa pjesë të fshatrave dhe një pjesë e qytetit janë goditur rëndë nga breshëri dhe vërshimet. Dje isha në vizitë në terren në fshatin Shajkoc dhe pashë edhe njëherë për së afërmi dëmet që janë shkaktuar në kulturën e boronicës që vërtetë është shqetësuese dhe prekëse dhe që ata që e njohin dhe shohin bujqësinë duhet të ndjehen keq për këto dëme që na kanë ndodh mirëpo ne së bashku duhet të gjejmë zgjidhje. Dëmet të cilat janë të evidentuara nga Komisioni përkatës deri më 01 korrik 2020, dhe që i kemi dërguar raportet përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që është institucioni përgjegjës për vlerësim dhe kompensim të dëmeve bashkërisht me Qeverinë e Republikës së Kosovës e që tash së fundmi kanë ndarë një buxhet prej 3 milion euro për kompensimin e dëmeve për fermerët në nivel vendi e për mendimin tim janë shumë pak dhe nuk i plotësojnë kushtet as për së afërmi. Sa kam informata 1.800.000,00€ veç se kanë filluar të procedohen dhe të kompensohen fermerët. Nga 01 janari 2020 deri më datën 31 mars 2020, komisioni përkatës komunal ka vlerësuar dëmet që janë shkaktuar në vlerë rreth 21.415,00€ në territorin e Komunës së Podujevës e që për këto dëme të shkaktuara në këtë periudhë ende nuk kemi përgjigje nga MBPZHR, pastaj nga 31 marsi 2020 deri më 29 maj 2020 vlerësimet e dëmeve kanë qenë në vlerë rreth 17.333,00€ e që për fatin e mirë nga Ministria përkatëse kemi përgjigje pozitive dhe jemi në procedurë me rregullimin e dokumentacioneve që fermerëve të prekur sipas raporteve për këtë periudhë t'iu kompensohen 25% e dëmeve të shkaktuara dhe vetëm pritet që mjetet t'iu dalin në llogaritë e fermerëve. Nga 29 maji 2020 deri më datën 01 korrik 2020, dëmet e vlerësuar në kulturat bujqësore arrijnë në vlerë rreth 98.443,00€, mirëpo për shkak të pandemisë Covid-19 shumë fermerë, dhe thirrjeve të institucioneve që fermerët dhe qytetarët në përgjithësi të mos të dalin si dhe orareve kufizuese një pjesë e fermerëve nuk kanë mundur t'i paraqesin kërkesat dhe dëmet e

tyre që u janë shkaktuara në kulturat bujqësore, mirëpo tash së fundmi nga komisioni përkatës është bërë edhe një vlerësim në terren për ata fermerë dhe me një aneks raport të vlerësimit të dëmeve të tyre janë vlerësuar dëme në vlerë 179.270,00€ e të cilat përmes Raportit të komisionit me shkresë të veçantë nga Nënkryetari i Komunës janë dërguar në Institucionet përkatëse kompetente për kompensim të tyre e që shpresoj shumë që të gjitha do të realizohen/kompensohen. Ne kemi biseduar me Ministrin e MBPZHR i cili mendoj se do t'i jap shumë mbështetje kësaj kategorie e cila është shumë e prekur. Rastet më të theksuara të fermerëve Llapjan të prekur nga fatkeqësitë natyrore janë fermerët nga fshatrat, Konushec, Buricë, Siboc, Sfeçël, Dumosh, Shajkoc, Herticë, fjala është për breshërin dhe vërshimet që kanë ndodh më 18 korrik 2020, pra janë dëmtuar pothuajse të gjitha kulturat bujqësore përfshirë edhe kulturën e grurit që tani veç se është në fazën e fushatës së korrje shirjeve e që sipas vlerësimeve është rreth 40% e dëmtuar si pasojë e breshëritë dhe vërshimeve.

Pas kërkesës që ka bërë Nënkryetari i Komunës nëpër rrjetet sociale dhe përmes televizioneve që na kanë shoqëruar në terren që është kërkuar nga të gjithë fermerët që kërkesat e tyre t'i adresojnë në institucionin përkatës-Komunën e Podujevës/Komisionin përkatës, janë paraqitur kërksat e fermerëve dhe menjëherë ekipet komunale kanë dalë në terren dhe janë duke bërë vlerësimin e dëmeve, dhe deri tani që unë po raportoј kemi rreth 68 kërkesa të fermerëve Llapjan që janë dëmtuar gjatë kësaj periudhe kohore.

Unë edhe njëherë ju falënderoj shumë për këtë iniciativë sepse është e qëlluar që të debatojmë, bashkëbisedojmë dhe të gjejmë zgjidhje. Kam kërkuar dhe do të vazhdoј të kërkoј çdo herë duke përfshirë edhe nga Institucionet qendrore që për vitin 2021 të na lejohet ne si Komuna dhe si Drejtori të bujqësisë ta kemi një kod të veçantë buxhetor në mënyrë që të mund të ndajmë buxhet për vitet e ardhshme për kompensimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në mënyrë që të mos varemi nga Institucionet qendrore por t'iu dalim në ndihmë fermerëve me ato mundësi që i kemi si Institucione komunale. Pra kjo është edhe kërkesa ime e vetme personale që në muajin shtator kur të miratohet buxheti i Komunës të na lejohet një gjë e tillë që një kod i tillë i veçantë për dëmet në bujqësi të realizohet, natyrisht edhe me mbështetjen e juaj si asamblistë.

Unë do të jem këtu deri në fund dhe do të dëgjoј secilin nga ju dhe aq sa di dhe mundem do të japë përgjigje, sqarime dhe informata të nevojshme, por ju them edhe njëherë se debati është shumë i rëndësishëm për këtë temë e cila duhet të trajtohet dhe debatohet me urgjencë por pa politika dhe pa anime politike, pa ngjyra politike por me qëllim që t'iu dalim në ndihmë fermerëve e që çdo kritikë, pyetje apo shqetësim tuajin do ta marrë me seriozitet.

z.Faik Muçiqi, drejtor Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - SHPMSH theksoi, edhe pse iniciuesi i kësaj seance u mor vetëm me problematikën e bujqësisë dhe ashtu i pati ato konstatime ndër të tjera duke kërkuar që të mos ketë politizime por rrëshqiti tërësisht në politizime dhe kualifikime, mirëpo mbetet çështje e juaja se si do ta trajtoni edhe nga aspekti i DSHPMSH sepse tema ka të bëjë me dëmet nga vërshimet edhe pse tani po merret që vërshimet shkaktajnë dëme vetëm në bujqësi mirëpo dëmet nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore bëhen edhe në ekonomitë familjare dhe në i infrastrukturë publike, e që për fat të mirë këtë vit këto dëme në këto dy kategori janë shumë më të vogla, megjithatë këtë vit patëm reshje të shumta të shiut në komunën tonë por edhe në Kosovë në përgjithësi e që përveç të mirave që sjellë shiu posaçërisht për kulturat bujqësore, për mbushjen akumulimit të liqenit të Batllavës që ka qenë problematikë këtë vit por që tani niveli i ujit në liqenin e Batllavës është 5.9 të mbushjes maksimale.

Shiu në disa lokalitete në Komunën e Podujevës ka sjellë edhe dëme të cilat drejtori parafolës i DBPZHR i paraqiti saktë ato që komisioni përkatës deri tani i ka konstatuar dhe vlerësuar rast për rast dhe që vazhdon t'i konstatoi. Sa i përket dëmeve që janë shkaktuar në infrastrukturë janë evidentuar pika që kanë qenë të ditura por që nuk kanë mundur të përfundohen, këtu kemi të bëjmë

kryesisht me infrastrukturën, shtretërit e lumenjve, urat apo ndonjë zgjerim të kanaleve atmosferike, problematika të cilat kanë qenë të theksuara posaçërisht në fshatin Siboc i Poshtëm ku shtrati i Lumi Dumnica me një gjatësi rreth 2.5 km (nga lagja Rrahmani deri në fshatin Llugë) ende nuk ka një trajtim të hapjes apo zgjerimit të shtratit si dhe një urë e cila është e vjetër dhe me lartësi të vogël por të cilën e kemi konsideruar si rast emergjent në fazën e tenderimit, kurse duhet të vazhdojë zgjerimi i shtratit të këtij lumi sepse në atë segment ka jashtëzakonisht probleme të theksuara pronësore dhe paqartësi në mes të banorëve.

Problematika e trajtimit të shtretërve të lumenjve edhe pse është kompetencë e Departamentit të Ujërave në Ministrinë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, jo ndikueshëm deri më tani në Komunën tonë janë marrë me këtë çështje edhe pse Komuna e Podujevës është një ndër komunat më të pasura me lumenj të ndryshëm sepse përveç lumit Llap kemi edhe disa lumenj tjerë ngase territori i Komunës së Podujevës është i madh dhe problemi ka qenë bukur i gjerë por edhe me miratimet e shpeshta buxhetore nga ana juaj sa i përket planifikimeve buxhetore, megjithatë në infrastrukturë afër lumenjve është punuar, madje po të mos ekzistonin ato zgjerime, mure mbrojtëse, ura, hapje të kanaleve e të tjera dëmet do të ishin shumë më të mëdha siç kanë qenë vitet paraprake.

Në fshatin Bellopojë (lagja Maloku) ka qenë një problem ku banorët e atij lokaliteti për fat të keq kanë penguar në punimet që janë bërë, mirëpo tani e kanë parë se çka do të thotë pengesa e hapjes apo punimit në një projekt të rregullimit të shtratit të lumit. Ne e kemi marrë si rast emergjent ndërtimin e një muri mbrojtës i cili është në tenderim, me gjatësi rreth 115m e që ndërtimi i atij muri mbi 80% do ta largonte problemin në atë lokalitet, megjithëse në atë pjesë kemi edhe një problem me një kanal atmosferik afër rrugës për disa shtëpi që janë nën nivelin e rrugës.

Në lumin Batllava, për fatin e mirë këtë vit nuk ka pasë derdhje të ujit për arsye se liqeni i Batllavës ka qenë jo i mbushur në maksimum, e them këtë ngase jeni në dijeni se viteve të kaluara ka ndodh që përnjëherë të ketë derdhje të ujit nga liqeni dhe vërshime në anën tjetër e që dëmet në fshatrat Gërdoc, Bellopojë, Llugë, Lupç kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha, por këtë vit nuk ka pasur derdhje nga lumi, prandaj ai lokalitet është më pak i goditur por që nuk do të thotë që edhe lumi Batllava nuk ka nevojë për trajtime të mureve mbrojtëse dhe urave eventuale siç është ajo në afërsi të lagjes Nesushta. Mendoj që me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor këtë vit do të investohet edhe në qytet, konkretisht në trajtimin e lumit Llap që do të vazhdon në të dy anët me ndërtimin e mureve mbrojtëse. Jemi në fazën e lidhjes së kontratës për rregullim të pikave të ndjeshme të rrezikshme në lumin Llap, përkatësisht nga fshati Lluzhan deri në rrugën magjistrale, projekt ky i cili është dy vjeçar dhe me një kosto të lartë, megjithatë të gjitha ato pika që përfshijnë disa fshatra, afër shkollave dhe institucioneve përgjatë shtratit të lumi Llap në atë pjesë do të kemi muret mbrojtëse ashtu siç i kemi deri në fshatin Lupç. Për këtë problematik kemi buxhet në shumë 280,000.00€, pastaj për muret mbrojtëse, për hapje dhe zgjerim të lumenjve dhe për ndërtimin e urave kemi buxhet në shumë prej 217,000.00€. Jemi në fazën e fillimit të punimeve të punimeve për ndërtimin e 15 urave dhe disa kalesave të ndryshme. Ekipet e Komunës të cilat kanë punuar në terren deri në orët vona në disa lagje si në fshatin Pakashicë kanë evidentuar dhe verifikuar edhe ura në këto raste sepse problematika e parë e stabilitetit infrastrukturor janë urat që goditen e që për fatin e mirë të gjitha janë stabile përjashtim ura në fshatin Dobërdol te lagja Rama e cila është një urë shumë e rrezikshme por që tani jemi në fazën e fillimit të punimeve për ndërtimin e një ure të re aty. Edhe për vitin e ardhshëm do të kemi paraparë buxhet por i cili mund edhe të rritet gjatë shqyrtimit nga ana juaj si Kuvend, fjala është për segmente të ndryshme në rreth 300,000.00€, pra për zgjerim të lumenjve, mureve mbrojtëse, kanaleve atmosferike dhe urave tjera. Rekomandim i imi personal është që duhet të vazhdohet në identifikim dhe vendosje të projekteve që duhet të realizohen, ato që kanë mbetë duhet të vazhdohet me zgjerim, rregullim të lumenjve posaçërisht aty ku janë fytet e

ngushta, pastaj duhet të vazhdohet me ndërtim të urave dhe kalesave në shumë lokalitete sepse sigurisht në secilin lokalitetit prej nga vini ju ka nevojë për ndërhyrje të tilla dhe eliminim të problematikave të ndryshme, prandaj ne si Komunë së bashku me Ministrinë e Ambientit duhet të kemi impakt më të madh financiar në trajtimin e këtyre problematikave.

z.Pajtim Balaj, theksoi, vërshimet dhe dëmet që ato iu shkaktajnë kulturave bujqësore në vazhdimësi kanë qenë problem për bujqit dhe për komunën tonë. Pavarësisht se çfarë ndihme ju ofrojmë sot çfarë mund tu ketë ofruar komuna dje, fakti që pas çdo shiu po përsëriten këto vërshime po tregon për neglizhencën e autoriteteve të qeverisjes lokale në gjetjen e një zgjidhje afatgjate e cila do të ishte produktive si për komunën ashtu edhe për bujqit, kështu as komuna që për çdo vit të shpenzoi para në stimulimin e bujqve të dëmtuar dhe as puna e tyre nuk do të ndërpritej.

Është investuar shumë në lumenj por nuk u është kushtuar aspak rëndësi rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave afër zonave ku vërshimet janë të shpeshta, po të bëni një vizitë në këto zona do të vëreni që nuk është vepruar në zgjerimin e shtratit e që pastaj ndodh shpesh të bllokohet nga bimë dhe drunjë që vështirësojnë qarkullimin e ujit dhe kur ka të reshura për pasojë kemi vërshime. Në vend që lumenjtë të shihen si ndihmesë në bujqësi, falë neglizhencës së komunës ata janë shndërruar në rrezik permanent për kulturat bujqësore shpesh edhe për vendbanime të ndryshme. E di që me natyrën nuk luftohet por ne mund të krijojmë mekanizma mbrojtës dhe parandalues të dëmeve.

LVV bujqësinë vazhdimisht e ka trajtuar me seriozitetin më të lartë si bazë e zhvillimit ekonomik lokal dhe jo të ndarë në investime nga një fshat në tjetrin por secilit fshat sipas perspektives bujqësore. Neglizhenca e komunës është vënë në pah sidomos në rajonet ku ka pasur çdo ditë vërshime si Sfeçël, Halabak, Bellopojë, Lupç, Tërnavë, Dumosh, Konushec dhe të tjera. Nuk është bërë asgjë që të hapen kanalet për t'i kulluar tokat me rastet e mëdha të shiut ndërsa komuna është përqendruar në më shumë investime prej nga vjen Ekzekutivi me ndërtimin e pendave të një pas njëshme e që kundër të cilave nuk jemi por jemi për orientim të investimeve bazuar në investime të barazisë për të gjitha lokalitet. E di që komuna mund të arsyetohet që në shumë raste banorët kanë qenë pengesë për kryerjen e punëve sidomos në zgjerimin e lumenjve dhe përroskave por kjo nuk mund të përdoret si argument nga shteti sepse shteti është bashkësia që e tejkalon individin angazhohet për të mirën e përbashkët dhe ka mekanizma për t'i zbatuar politikat e saj edhe atëherë kur individ të caktuar mund të jenë pengesë si dhe ka mekanizma obligues dhe ndëshkues.

Shteti nuk mund të gjunjëzohet përballë asnjë individi sepse ai është mbi secilin individ. Sipas vlerësimit të dëmit nga komisioni komunal, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, propozoj që si masë e menjëhershme për bujqit e dëmtuar të subvencionohen me 50% të vlerës së dëmit të shkaktuar nga fondi emergjent ose nga fondi i subvencioneve. Nga vizita në terren e kemi parë që përveç kulturave bujqësore dëme janë shkaktuar edhe në mjetet ndihmëse të punës siç është sistemi i ujitjes prandaj ndihma prej 50% sado pak i mundëson rivitalizimin e sistemit në mënyrë që dëmet të përballohen sa më lehtë dhe të dilet nga kjo gjendje sa më shpejt. Kjo ndihmesë bëhet gjithmonë duke u përcjellë me një proces të monitorimit transparent në terren. Përgjithësisht kjo fushë përcillet me shumë vështirësi dhe probleme si, mos koordinim institucional për zgjerim paqartësia për pikat kritike të rreziqeve në këtë rast nga vërshimet, problemet pronësore dhe kadastrale, mungesa e efikasitetit të inspektoratit, mungesa e komunikimit efikas me banorët dhe mes banorëve, vonesat në vendosjen e kolektorit, kontaminimi i ujërave, mungesa e fondit të qëndrueshëm të emergjencave apo garantuesve për bujqësi, mungesa e transparencës në evidentimin e dëmeve.

Me qëllim që të gjendet një zgjidhje e përbashkët për këto probleme ne si LVV i propozojmë Kuvendit të Komunës këtë deklaratë dhe ju bëjmë thirrje gjitha subjekteve që përfaqësohen në Kuvend që ta votojnë, dhe atë duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kapitulli 10,

ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për bujqësi dhe zhvillimin rural si dhe Statutin e Komunës së Podujevës dhe Rregulloren e punës të Kuvendit Komunal të Podujevës paraqesim këtë deklaratë, si vijon,

Komuna e Podujevës njihet për produktet e saja bujqësore, bujqit dhe fermerët e Komunës tonë janë punëtorë dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social jo vetëm në komunën tonë por edhe më gjerë, si zgjidhje me plan afatgjatë të këtyre problemeve Kuvendi i propozon Ekzekutivitet që brenda 30 ditësh të sjellët një plan veprimi për pikat kritike të rrezikut, të veprohet në koordinim të plotë institucional, evidentimi dhe shënimi i lumenjve dhe pronave, diskutime me banorët për gjetjen e zgjidhjeve, përfundimin e kolektorit në afat optimal, transparencë të plotë në evidentimin e dëmeve dhe në shpërndarjen e ndihmave të tyre. Kompensimin e dëmeve deri në një shumë prej 50% sipas vlerësimit të dëmeve nga Komisioni Komunal, krijimin e fondit garantues për participim, sigurimin e bujqve për vitin 2021, të themelohet një kod buxhetor në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit me titull rehabilitimi i shtretërve të lumenjve, me fonde të mjaftueshme për të adresuar problemet që dalin nga pika e parë e këtyre rekomandimeve.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sa i përket temës për të cilën sot është thirr seancë e jashtëzakonshme lidhur me dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore nga vërshimet dhe breshëri, ne morë një informatë nga drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural zotëri Januzi lidhur me periudhën kohore kur kanë ndodhur këto vërshime, respektivisht periudha kohore 01 janar 2020 deri më 18 korrik 2020. Siç e potencoj drejtori dëmet janë jashtëzakonisht të mëdha në disa fshatra të cilat edhe i ceku dhe ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së mbështesim që urgjentisht në koordinim me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural t'iu dilet në ndihmë sa më shpejt kësaj kategorie, po ashtu mbështesim edhe idenë dhe propozimin e drejtorit që është nevojë urgjente që në vitin 2021 të nxjerrët një kod i veçantë buxhetor për këtë kategori. Sa i përket kualifikimeve apo temave tjera me element politik nuk do të lëshohem kësaj radhe pasi besoj që qëllimi i këtij takimi është që t'iu dalim në ndihmë fermerëve Llapjan.

Po ashtu si Grup i LDK-së nuk e përkrahim as deklaratën e propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëgjuam raportimin e dy drejtorëve përkatës dhe fjalimin e iniciuesit të seancës së jashtëzakonshme dhe mendoj që nga seanca duhet të dalim me një konkluzion apo me një vendim për arsye se të gjithë parafolësit e grupeve politike u deklaruan që jemi në mbështetje të problemit ekzistues i cili nuk ka ardhur nga faktori njeri dhe që të unifikohemi për problemin.

Sa i përket kompensimit gjithsesi mendoj se të gjithë jemi për t'i mbështetur bujqit dhe fermerët por këto janë më shumë deklarata morale se sa vendime që mund t'i marrim sepse ne këtu kemi vetëm kompetenca lokale dhe nuk mund t'i dirigjojmë mjetet qendrore. Lidhur me kompensimin e dëmeve nga mjetet qendrore mendoj se mund të dërgohen vetëm dokumente dhe kërkesa për shumën 3 milion euro që është ndarë në nivel vendi, asgjë më tepër dhe kjo është diçka që vetëm mund ta diskutojmë. Mendoj që të gjithë ne këtu e dimë sa është shuma e mjeteve që ne sot bëjmë kërkesë për t'i mbështetur fermerët, por pyetja ime është, a ka Komuna mjete rezervë të cilat duhet të shkojnë në mbështetje të fermerëve apo jo, e them këtë sepse ne jemi duke diskutuar për mbështetje financiare e jo për mbështetje morale sepse fermerët i duan mjetet e jo t'ju thuhet, jam me ty. Problematika që është dashur të diskutohet është se ky nuk është dëmi i parë i krijuar nga vërshimet, problematik për DBPZHR do të ishte që në vitin 2020 është dashur të mendohet për një kod të ri buxhetor që në miratim të buxhetit, në planifikimin vjetor që e kemi bërë, të bëjnë kërkesë Grupet e këshilltarëve që nga të hyrat vetanake të ndahen mjete buxhetore sepse me të hyra vetanake komuna mund të punoj dhe ndaj mjete ngase aty nuk ka qasje askush përveç komunës andaj edhe ka pasë mundësi të ndahen mjete buxhetore për këtë çështje, mirëpo nga Drejtoria përkatëse nuk kemi pasë kërkesë për këtë, pastaj as nga DSHPMSh nuk ka pas kërkesë për ndarje buxhetore edhe pse kanë

qenë vërshimet e viti 2017 ku kryetar i komisionit ka qenë drejtori z.Faik Muçiqi, por nuk ka pasë as raportim.

Element i dytë për mua është se a ka jap komuna mbështetje për dëme qe 20 vite, e them këtë ngase po të ishin vërshimet dhe dëmet e para të paraqitura do të duhej të ballafaqohemi, andaj me problemin ne duhet të merremi jo vetëm të diskutojmë dhe për këtë mendoj që nëse seanca është thirr vetëm për të diskutuar ne nuk jemi në rregull por duhet të zgjidhim problemin, të marrim një vendim sot ose për ndryshe mos të thirren seanca vetëm për të krijuar barrë financiare sepse kjo seancë i kushton buxhetit shtetëror, pavarësisht që këshilltarët paguhën 100.00€ për seancë, më së paku për këtë seancë janë shpenzuar mbi 15,000.00€ të cilat duhet paguar përfshirë edhe për anëtarët e KPF-së kështu që duhet të mendojmë edhe për këtë çështje edhe nëse dalim pa asnjë konkluzion dhe pa asnjë vendim nga kjo mbledhje i bie që mbledhja është thirrur vetëm ashtu. Pastaj kemi të bëjmë me propozimin e drejtorit të Drejtorisë përkatëse se si ai mendon ta zgjidh këtë problem ngase ai menaxhon me atë Drejtori, andaj mendoj se në qoftë se propozimi i tij është i realizueshëm dhe i pranueshëm ne duhet ta votojmë sepse me Drejtorinë Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk menaxhojmë ne si këshilltarë të Kuvendit por ne vetëm mund të diskutojmë. Buxhet i miratuar është ashtu siç e ka paraparë drejtori i Drejtorisë përkatëse me mbështetjen e LDK-së dhe disa këshilltarëve që kanë përkrahë, pra buxhetin nuk e kemi paraparë ne e që tani po kërkohet të bëjmë zgjidhje, në fakt ne kemi paraparë planifikimet buxhetore por pak më ndryshe se si duhet shpenzuar por asnjë drejtor nuk ka ardhë dhe ta prezantoj planin e vet, me përjashtim të një Drejtorie e cila ka sjellë planin se si ne ta mbështesim atë me buxhet, pra këtu është problemi kryesor, do të thotë, kështu në këtë formë deri në përfundim të këtij viti kalendarik e ka paraparë buxhetin DBPZHR që të zgjidh problemin aktual që e kemi lidhur me këtë fushë, dhe është mbështetur ideja dhe propozimi i tyre. Pajtoj me atë që u tha se nuk është mirë të politizohet kjo temë dhe kjo seancë mirëpo kemi edhe mundësinë tjetër që me rishikim të buxhetit të ndajmë mjete për këtë problematikë mirëpo problem paraqitet këtu edhe mos prezenca e drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në këtë. Konsideroj se kjo seancë është më shumë populliste sepse nuk ka këshilltarë politikë që del këtu në foltore dhe të deklarohet se është kundër fermerëve dhe bujqve, pasi që kjo seancë nuk është politike por është populliste dhe morale, mirëpo duhet treguar sa është buxheti rezervë, sa janë të hyrat vetanake, që drejtori të shkoi te Nënkryetari i Komunës dhe t'i thotë që në muajin shtator është mirë të ndahen 100,000.00€ dhe nga kjo shumë të përfitojnë 100 fermerë të dëmtuar me nga 1000€, pra orientimisht kjo ishte si shembull, përndryshe diskutojmë këtu për 4 orë dhe vazhdojmë në shtëpitë tona apo posa të dalim nga këtu ndokush të shkoi te ndonjë fermer dhe t'i thotë se unë të mbështeta këtu ose atu. Sa i përket propozimit të deklaratës së kolegut nga LVV-ja, mendoj që nuk është dashur të quhet deklarata ai dokument sepse për mua personalisht deklarata paraqet diçka tjetër, por nuk ka të bëjë me ndonjë vendimmarrje.

Mendoj që evidentimi dhe zgjerimi i lumenjve dhe pronave mund të ndodhë, edhe pse drejtori i drejtorisë përkatëse nuk është prezent këtu të jap përgjigje apo sqarime, por pronat janë të regjistruara në dokumentet kadastrale ndërsa në qoftë se keqpërdoren nga ndokush është çështje tjetër, por nuk ka pronë që kadastru i Kosovës dhe ai Komunal nuk është në dijeni se ku është ajo pronë, kështu që kjo pikë bie sepse ato janë të regjistruara. Nëse ekskluzivisht keni ndonjë pronë të paregjistruar në kadastrë duhet ta sjellëni me argument. Sa i përket diskutimet me banorët për zgjidhjen e problemeve, mendoj se banorët nuk zgjedhin probleme por zgjedh qeverisja si akter që merr vendime, e them këtë ngase po të pyeten qytetarët të gjithë kanë mendime ndryshme duke u nisë së pari nga familjet e tyre e deri në shoqëri, kështu që edhe kjo pikë bie, kurse sa i përket kërkesës që përfundimi i kolektorit në afat optimal, pajtohem se është në rregull, ashtu siç e mbështes edhe atë që të ketë transparencë të plotë në evidentimin e dëmeve dhe shpërndarje të

ndihmës, pra unë jam duke treguar se çfarë personalisht mbështes e çfarë jo në deklaratën e propozuar. Drejtori i Drejtorisë përkatëse e potencoi se është krijuar një komision, por është mirë të ceket edhe përbërja e atij komisioni, periodhat e raportimit të atij komisioni dhe çështje tjera të nevojshme dhe do e mbështetja këtë pikë nëse është bërë apo nëse bëhet transparente sepse komisioni ngritët prej Ekzekutivit i cili po ashtu duhet ta bejçe transparent atë ndërsa ne e shohim pastaj a është bërë transparent ai komision apo jo. Mandej patëm si kërkesë në deklaratë edhe kompensimin në shumë deri në 50%, e që edhe këtë pikë moralisht në mënyrë absolute e mbështesim, madje edhe 100%, kurse rreth dëmeve të vlerësuara nga komisioni mendoj se kjo pikë duhet të renditet më lartë në deklaratë sepse në qoftë se nuk ka transparencë ne nuk mund ta dimë. Sa i përket Krijimit të fondit garantues për participim për sigurimin e bujqve, konsideroj një participimi i tillë po bëhet për çdo vit nga fermerët, shembull kemi projektin për përkrahje me motokultivator që është bërë, madje e dimë edhe çmimin e tregut, pra kush dëshiron të merret me gjëra të tilla dhe kryej punën dhe detyrën e vet është në dijeni se participimi nga fermerët po ndodh, madje unë jam në dijeni edhe sa ka qenë participimi për motokultivatorët, çmimin e tregut sa kanë hyrë në Kosovë, prej cilit vend kanë ardhë etj, sepse kam pasë interesim dhe e di e që nëse dëshironi mund t'ju tregoj, mirëpo nuk e kemi temë këtë çështje. Prioritet sot e kemi ta diskutojmë rreth mungesës së kodit buxhetor për dëme e që është defekt i drejtorit i cili asnjëherë nuk bërë kërkesë për një gjë të tillë ashtu siç nuk ka parashtuar kërkesë për ndarje të buxhetit për dëme të shkaktuara nga vërshimet dhe breshëri, pra për këto dy mandate sa jam në Kuvend asnjëherë nuk është bërë një gjë e tillë. Ne kemi diskutuar me Kryesuesin e Kuvendin z.Fatmir Gashi dhe me ish Kryesuesin z.Mehmet Gashi dhe kemi insistuar që bashkërisht drejtorët e Drejtorive të shikojnë se si të ndajmë buxhet për çështje të caktuara, por dhe nuk ka pasë vullnet prandaj ky është defekti i drejtorit përkatës dhe i atij të kaluar. Sa i përket Rehabilitimit të lumenjve janë çështje të cilat ndërlidhen në disa aspekte me nivelin qendror siç u tha, por ne nuk kemi kohë të presim se çfarë planifikon të bënë Qeveria, ne duhet të shikojmë se çfarë mund të bëjmë ne dhe se askush nuk ka kompetencë që as edhe 1000€ t'i sjellë prej niveli qendror këtu ngase nga niveli qendror janë ndarë 3 milion euro në nivel vendi për dëme, por mund të ndodhë që ndoshta as 3€ niveli qendror si ndanë për Komunën e Podujevës. Orientimisht është mirë me gjetë gjuhën e bashkëpunimit pasi që Ministri dhe ish Ministri ka qenë i linjës politike, është edhe nga Llap, nuk e them këtë që të politizohet dhe të ketë ndarje regjionale por të shikohen drejtë dhe realisht dëmet në Llap në mënyrë që pastaj të ndahen mjete buxhetore për kompensimin e fermerëve për dëmet e shkaktuara.

Kështu që i nderuar Kryesues i Kuvendit mendoj që është mirë të mbetet si përfundim që drejtori i DBPZHR të dalë me konkluzionin e vet se si mendon ta zgjidhë çështjen e kompensimit dhe pastaj ne do të shohim mundësinë për ta votuar, se si do të jetë ndarja e mjeteve, prej kodit të ri e që për këtë vit kod të ri nuk ka dhe tani jemi vonë për të kërkuar diçka të tillë, pa dashur që për 20 vite pas luftës të gjitha t'ia adresoj drejtorit aktual dhe ta gjykoj atë për vonesat 20 vjeçare.

Pastaj në vitin 2017 drejtori i DSHPMSh z.Faik Muçiqi pati thënë se do të raportoi për dëmet e shkaktuara por nuk e ka bërë një gjë të tillë, madje as nuk ka bërë kërkesë për kod të ri dhe tani duhet të presim edhe një vit, prandaj urdhëroni dilni me ndonjë ide tani se si duhet ta zgjidhim këtë problem sepse të gjithë jemi me fermerët, pra të mos debatojmë gjatë kështu dhe të mos humbim kohë pa nevojë por të dalim me ide konkrete dhe të marrim qëndrim.

z.Avni Islami, theksoi, të vetmen pikë të rendit të ditës që e kemi ka të bëjë me vërshimet që kanë ndodhë para disa dite dhe secili nga ne besoj që e ndan të njëjtin shqetësim lidhur me këto vërshime. Në fakt nuk është viti i parë që ndodhin vërshime, këto problematika edhe vitin e kaluar i kemi ngritur si çështje këtu në Kuvendin Komunal, sigurisht edhe paraardhësit tanë që kanë qenë i kanë ngritur këto shqetësime, pyetja ime është për ata që janë kompetent të japin përgjigje qoftë drejtori i

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ose drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që në konsultim edhe me zyrën ligjore se a kemi të drejtë ne si Kuvend Komunal me ngrit një fond të veçantë që sa herë kemi telashe dhe vërshime të jem të gatshëm që t'i ndihmojmë qytetarët tanë, nuk është vetëm toka bujqësore por kemi pasur raste edhe vitin e kaluar kur uji ka vërshuar edhe nëpër shtëpia të banimit dhe nuk kemi pasur mundësi t'iu ofrojmë një ndihmë minimale.

Pyetja është a kemi bazë ligjore që ta bëjmë një fond dhe kështu t'iu përgjigjemi nevojave të qytetarëve. Unë nuk kisha dashur që të përzihet fondi për subvencione dhe fondi për ndihma emergjente për shkak se fondi për subvencione është fond i cili ju ka gjind qytetarëve tanë dhe besoi që e ka mbërri efektin e tij, nuk them se është i përkryer por së paku duken kulturat bujqësore që janë subvencionuar nga Komuna për të tjera le të merren komisionet e veçanta, mirëpo këto dy fonde nuk kisha menduar që duhet përzier apo të përgjysmohet fondi për subvencione sepse prapë po vij çështja te baza ligjore që të formohet një fond i veçantë në mënyrë që t'iu dilet në ndihmë qytetarëve. Pra kjo është pyetja që mendoj se është fundamentale edhe për përgjigjet tjera që tu gjendemi qytetarëve pranë.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, ajo për çka jemi mbledhur sot këtu në fakt janë dëmet të determinuara nga një fuqi tjetër hyjnore të cilën ne nuk mund ta kontrollojmë në asnjë situatë, por që natyrisht që ne jemi mbledhur sot këtu për të parë se çfarë mund të bëjë njerëzoria për këto dëme të shkaktuara. Unë mendoj që përveç 25% të Ministrisë natyrisht se duhet të gjenden mundësi për të iu ndihmuar këtyre njerëzve të vyer Llapjan të cilët jo vetëm se e sigurojnë mbijetesën për vetën dhe për familjet e tyre por duke e larguar në këtë formë barrën e tyre prej komunës dhe shtetit njëkohësisht ata kanë mundësuar që nëpërmes kësaj pune të palodhshme ta shndërrojnë Llapin në një markë të kultivimit të shumë produkteve në Kosovë dhe jashtë saj. Përveç kësaj gjendja e rënduar ekonomike pas pandemisë Covid-19 e ka shndërruar bujqësinë në një shpresë të pa diskutuar për çdo familje Llapjane prandaj unë mendoj, është mendimi im nga ajo që u tha deri më tani nga të gjitha palët dhe nga të gjitha diskutimet që u bënë deri në këtë pikë, unë personalisht përkrahi por mendoj që falë një bashkëpunimi ta ridizajnojmë këtë përfundim nëse mund të them kështu.

Unë personalisht mendoj që në këtë seancë duhet të nxjerrët një përfundim dhe dy rekomandime. Përfundimi është që Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të na njoftoi se nëse janë mundësitë të ndihmohen buqit dhe fermerët, po ose jo, dhe cilat janë mundësitë ligjore qoftë buxhetore dhe të tjera,.

Rekomandimet që i përkrahi fuqimisht janë këto, e para që të krijohet, në fakt jo vetëm të themi në mënyrë deklarative por unë konsideroj që është momenti i fundit, që edhe në deklaratë dhe në praktikë të krijohet një fond i veçantë në një të ardhme më të afërt që është e mundur që të ndihmohen këta njerëz të vyer me të cilët të gjithë jemi krenarë për punën që ata bëjnë, në mënyrë që edhe ata të ndihen komod në punën që e bëjnë. Po këtë komoditet ta ketë edhe institucioni që në raste të këtyre fatkeqësive të cilat ne nuk mund ti parashikojmë, t'iu dilet në ndihmë.

Tjetra që bie më shumë në domenin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, unë mendoj që duhet të punohet më shumë në parandalim, pra të evidentohen ato situata që në rast të fatkeqësive natyrore do të na përkeqësonin situatën.

z.Fatmir Rudari, theksoi, i dëgjova dhe përcjella me vëmendje disa propozime dhe sa munda të mbaj mend janë tri propozime dhe tani edhe unë propozoj që propozimet e bëra të harmonizohen dhe të dalim me një konkluzion prej kësaj mbledhje. Këshilltari z.Pajtim Hodolli pati një propozim, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural pat disa propozime pothuajse të ngjashme me deklaratën e LVV-së, prandaj unë propozoj që të bëhen bashkë të gjitha këto propozime përkatësisht të harmonizohen dhe në mënyrë që ta përfundojmë debatin dhe të dalim nga kjo mbledhje me një qëndrim si Kuvend i Komunës, pra ose të shkojmë në një pauzë në mënyrë që

të konsultohemi mes veti ose të presim nga drejtori i DBPZHR ndonjë propozim më konkret që të paktën të dalim me një konkluzion të qartë. E them këtë sepse po e vërej që vullneti i këshilltarëve është të mbështet gjë që edhe në të kaluarën kemi jep shembuj se për situata të tilla kemi qenë gjithë së bashku, andaj shpresoj se edhe sot do të jemi ashtu por që vetëm e vetëm të dalim me një propozim të harmonizuar nga të gjitha Grupet e këshilltarëve apo subjektet politike të përfaqësuara në këtë Kuvend.

z.Vendenis Lahu, theksoi, dëgjova me vëmendje kolegët parafolës të cilët diskutuan dhe nuk dëshiroj të përsërisë atë që thanë ata sepse edhe ashtu pajtohem me atë që e thanë. Fermerët të cilët kanë pësuar dëme në kulturat e tyre bujqësore mendoj që duhet të mbështeten ashtu siç mendoj që do të ishte mirë të dalim me një konkluzion nga kjo mbledhje siç u tha më herët që i mbështesim sepse në fund të fundit ata qytetarë janë taksapagues dhe i gjithë buxheti i shtetit dhe i komunës bëhet në bazë të taksave të cilët i paguajnë qytetarët. Kësisoj mendoj që të gjithë kanë të drejtë të trajtimit të barabartë, pajtohem me drejtorin kur tha se nuk duhet bërë politizimi i kësaj çështje por do të doja të shtoja që politizimi i këtyre çështjeve zakonisht ka premisa për të cilën po fillon politizimi i saj, ndoshta e ka zanafillën edhe më herët qoftë me ndarjen e subvencioneve qoftë me proceset tjera ku shumë qytetarë po diskriminohen, qoftë në baza partiake apo shkaqe tjera.

Unë kam marrë disa ankesa nga disa qytetarë duke lënë anash ndarjen e subvencioneve të cilët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë edhe në rikuperimin e dëmeve të cilat i kanë pësuar përgjatë fatkeqësive natyrore viteve të kaluara, fjala është kur janë ndarë mjete buxhetore nga Qeveria për kompensimin e këtyre dëmeve. Prandaj mendoj që është e rëndësishme që të dalim me një konkluzion dhe ta votojmë edhe ne si Kuvend ndoshta një ekip i cili do ta bënte evidentimin dhe mbikëqyrjen e punës rreth ndarjes së kompensimeve e cila nëse arrijmë ta bëjmë do të ishte shumë mirë dhe komisioni ta bënte mbikëqyrjen e ndarjeve të kompensimeve sepse kjo do të siguronte një transparencë për ndarje të barabartë për të gjithë fermerët e dëmtuar.

z.Patriot Rudari, theksoi, unë vetëm pak po ndalem në aspektin gjeografik për lumenjtë diçka sepse edhe drejtori z.Faik Muçiqi foli rreth tyre kështu që po jap disa sqarime. Ne e dimë shumë mirë se këtë vit deri në fillim të muajit maj ka pasë një thatësi shumë e madhe por më vonë muaji maj dhe qershor kanë qenë muajt më të lagështë të viti. Muaji me lagështi më të madhe në 16 vitet e fundit ka qenë muaji qershor i këtij viti, me 182 mm reshje, do të thotë prej se kanë filluar matjet e reshjeve prej vitit 2004. Tani niveli i ujit në liqenin e Batllavës që ka qenë rreth 9 metër nën nivelin maksimal tani pas reshjeve të fundit niveli i ujit në liqenin e Batllavës është rritur dhe niveli është nën 5.5 metër nën nivelin maksimal, mirëpo Lumi Dumnica i ka rreth 87 km² ujë mbledhës, ndërsa liqeni i Batllavës i ka 315 km² ujë mbledhës, afër katër herë më shumë se lumi Dumnica.

Kërkoj nga Komuna e Podujevës, me theks nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që konkretisht në fshatin Bellopojë, në 2-3 pika/vende që po ndodh të del lumi nga shtrati, të zgjerohet ai shtrat ngase po të ishte në këtë kohë liqeni në nivelin e ujit maksimal, sigurisht që do të ndodhte që prej fshatit Batllavë deri në fshatin Lupç do të kishte vërshime të pa parashikuara e njëkohësisht kuptohet edhe dëme të shumta.

z.Hasan Ajeti, theksoi, edhe një herë atë çka dua të vlerësoi është se Drejtori i DBPZHR e potencoj që ka pasur një takim me Ministrin e MBPZHR, takim i cili konkretisht është zhvilluar lidhur me këtë temë të cilën po e diskutojmë. Për mundësitë që ka komuna natyrisht se duhet të jemi transparent, ka apo nuk ka mundësi për mbështetje dhe duhet të dilet këtu në foltore të jap sqarimet e nevojshme qoftë para neve qoftë para opinionit, gjë të cilën edhe disa nga kolegët e potencuan, në veçanti z.Rafet Llapashtica, e që nuk kemi nevojë dhe nuk jam ithtarë i asaj që t'i jepet element politik kësaj teme dhe as kualifikime të ndryshme, mirëpo nuk dëshiroj të lëshohem në atë që e tha

kolegu nga LVV-ja kinse ka pas diskriminim për raste të caktuara, por nëse ka pasë prezent këtu e kemi drejtorin e Drejtorisë përkatëse, atëherë cekeni me emra të përveçëm.

Jam i vetëdijshëm se njerëz jemi dhe jam i vetëdijshëm po ashtu që krejt bardhë nuk është por edhe krejt zi nuk është. Sa i përket ndihmës për fermerët dhe mundësive buxhetore, prezent po ashtu është drejtori përkatës i cili është kompetent të na sqaroj sa janë mundësitë që MBPZHR t'i mbështetë fermerët Llapjan të cilët janë dëmtuar. Drejtori në fjalë e potencoj edhe më herët që është formuar një komision, andaj lidhur me atë që u kërkua ta formojmë edhe një komision paralel, gjykoj se do të ketë telashe qoftë procedurale qoftë lëndore rreth kompetencës për këtë çështje, mirëpo mendoj se drejtori i DBPZHR mundet edhe një herë të na sqaroj në detaje lidhur me takimin që ka pasë me Ministrin e MBPZHR, cila ka qenë përgjigja e Ministrit dhe sa është afati apo mundësia që ne sot ta kemi informatën rreth asaj që t'iu dalim në ndihmë fermerëve Llapjan.

z.Vendenis Lahu, theksoi, unë me fjalën time nuk iu referova direkt drejtorit të DBPZHR sepse mendoj se kishte me qenë e pa drejtë t'i referohesha specifikisht drejtorit në fjalë për shkak se diskriminimi në baza partiake nuk ndodhë konkretisht nga ky drejtor ngase në Komunën e Podujevës ato janë evidente dhe është e pa kuptim të mohohen këto gjëra, madje edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit i cili është aty ulur në rreshtin e parë është në dijeni, dhe do të ishte paksa qesharake nëse del dhe e thotë që nuk ka diskriminim politik ose çfarë do qoftë të natyrave tjera, ne i dimë të gjitha dhe është temë që s'ka koment besoj.

z.Agim Blakqori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit - DKA, theksoi, u përmend emri im, dhe tema për të cilën është thirr kjo seancë doli nga pika e rendit të ditës, mirëpo megjithatë përgjigja ime për parafolësin është se nuk kam informacion që ka diskriminim.

z.Agim Behluli, theksoi, unë i përkrahi bujqit dhe kërkesat e tyre plotësisht, por i kam dy propozime sepse ne që jemi pak më të vjetër e mbajmë në mend që në fshatin Shajkoc ka qenë një stacion me raketahedhës për shpërndarjen e reve, andaj propozoj që ai stacion të kthehet në funksion në mënyrë që të paktën të na mbroj nga reshjet e breshëritë.

Propozimi tjetër është, që bujqit të vetëdijesohen, përkatësisht t'i sigurojnë pronat sepse kjo ndodhë në gjithë botën. Vërshimet dhe breshërin nuk ka mundësi t'i ndalojë askush por duhet të mësohemi ta sigurojmë pronën, shembull, kur është fjala te kultura e boronicës dhe kulturat tjera bujqësore që kanë çmim të lartë në treg, të sigurohen ato. Besoj se propozimet që i bëra janë me vend, madje nëse rifunksionalizohet stacioni i raketahedhëseve në fshatin Shajkoc do ishin punësuar aty dikush dhe sa do pak breshëri do të ndalej.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, unë ju bëjë thirrje të gjithëve që ta votoni këtë deklaratë pavarësisht dallimeve politike dhe se nga cila parti vijmë ne, fundja mos e bëni për LVV-në por bëjeni për fermerët Llapjan, mos e përbuzni mundin dhe djersen e tyre. Në rastet si këto ne duhet ti kalojmë inatet politike, inat politik për mua është kur ndonjëri nga kolegët e mi ngritet dhe thotë ne nuk e votojmë një deklaratë që vije nga LVV, pa i japë arsyetimet e tij. Për çdo sugjerim dhe vërejtjet që keni për deklaratën ne jemi të hapur që t'i pranojmë ato dhe jemi shumë kureshtarë me i dëgjuar, fundja edhe ne duam të dimë se çfarë standardesh keni ju. Një sqarim për z.Rafet Llapashtica meqenëse ne nuk mundemi të bëjmë rezolutë në Kuvendin Komunal atëherë e kemi parë të arsyeshme që duhet të bëjmë në formë të deklaratës.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, fillimisht si iniciues i kësaj seance dhe më vie mirë se përnjëmend paska pasë nevojë të diskutohet për këto fatkeqësi natyrore dhe kisha dashur të ndërlidhem pak me dy drejtorët të cilët janë këtu prezent, nuk i mohoi dy gjëra të mira, që kanë dalë në terren dhe e kanë shikuar gjendjen me të cilën po ballafaqohen qytetarët, dhe e dyta që sot në mbledhje janë prezent. Drejtori i DSHPMSh zotëri Muçiqi e përmendi që mos me u lëshuar në deklarata politike.

Është e vërtetë ajo por unë nuk mund të mos e përmendi që gjatë fushatës dalin dhe i keqtrajtojnë qytetarët duke bërë fotografi dhe duke japë subvencione në shesh, duke mos e bërë publike listën që fermerët pastaj të shkojnë vetë me i marrë mjetet e tyre kur është koha. Te investimet që është dashur të ndodhin fajet i keni vet ju se që 20 vite jeni në pushtet dhe është dashur t'i parashikoni dëmet që munden me ndodhë prej tyre. Drejtori i DBPZHR i konstatoi dëmet se si kanë ndodhë dhe vizitat që ka pasë në terren, por unë desha t'ia parashit një pyetje dy drejtorëve (DBPZHR dhe DSHPMSh) se çfarë keni paraparë ju që t'i ndaloni këto dëme dhe a i keni kompensuar ndonjëherë fermerët prej se jeni në pushtet deri më tani, sepse të paktën unë nuk kam deklarata për këtë.

Te deklarata e LVV-së, parimisht e mbështes mirëpo kishte qenë mirë që për disa pika të konsultohen edhe me Grupin e këshilltarëve të PDK-së, për t'i bërë disa ndryshime të nevojshme.

z.Faik Muçiqi, drejtor DSHPMSh, theksoi, jo për të shkaktuara polemika por edhe gjatë diskutimit po mendoja të dalim me dy ose tri çështje që janë të rëndësishme dhe janë ligjore. Disa nga ju po flisni për fond, por fond nuk formojnë Komunitat por Qeveria e Republikës së Kosovës, ligjet aktuale nuk lejojnë krijimin e fondeve, qofshin ato emergjente apo të tjera. Kur flasim për subvencione, është një kategori e subvencioneve që çdo vit Qeveria e ka një limit që planifikon rreth 400,000.00€ deri në 500,000.00€, shumë të cilën duhet shikuar se si do ta shpërndan dhe a mund të ketë kompensime brenda këtij fondi, qoftë kompensim indirekt që për mendimin tim nënkupton se nëse një fermeri ju ka dëmtuar sistemi i ujitjes a mundet Drejtoria komunale dhe Kuvendi i Komunës që atë sistem t'ia jap edhe njëherë, pra ky do të ishte një lloj kompensimi indirekt. Po ashtu në bazë të ligjeve aktuale nuk lejohen Fonde emergjente, unë këtë çështje para 5 ose 6 viteve e kam iniciuar se çfarë të bëjmë me këto problematika të dëmeve që shkaktohen, jo vetëm nga uji por edhe nga zjarri nga erërat e të tjera sepse nuk janë dëme natyrore vetëm këto por përgjigja ka qenë se nuk keni të drejtë sepse duhet të shikohet aspekti i ekonomisë së tregut (ajo që tha edhe këshilltari z.Agim Behluli) që edhe bujqit edhe të tjerët t'i kenë sigurimet për produktet dhe për ekonominë familjare sepse ne kemi pasur raste që nga shkaktimi i zjarreve janë djegur edhe fabrika me dëme të konsiderueshme dhe nuk ka mundur t'i kompensoj komuna.

Edhe në deklaratën sa kuptova e juaj u përmend një fond për rehabilitimin e lumenjve mirëpo zotëri z.Balaj nëse pak keni dëgjuar me vëmendje edhe investimet janë të përhershme, për këtë vit zgjerimin dhe rregullimin e shtratit të lumit Llap e kemi miratuar ju në këtë Kuvend, pra e kemi fondin për investimin në rastet emergjente, shtrohet pyetja, çka është ky fond për raste emergjente, bukur shumë kam pasë problematika para 4 ose 5 viteve që t'ia sqaroj Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave se çka është ky fond i cili nuk lejohet por e kemi sqaruar se ky fond mund të përdoret vetëm në raste, shembull, nëse ndodhë një fatkeqësi vetëm në infrastrukturë, një urë e cila mund të jetë dëmtuar e që nuk janë në planifikime buxhetore e që nga ai fond emergjent i investimeve kapitale do të mund të investohet, kurse subvencione kursesit.

Pranojeni që kompensimet të bëhet vetëm përmes fondit të subvencionimit, jo përmes fondeve të veçanta komunale sepse fondet nuk i formojnë komunitat, pra këto janë dy ose tri çështje që i vëreja në diskutimin e z.Pajtim Hodolli, mund të mos pajtohem bukur shumë me këshilltarin e cekur dhe nuk dëshiroj të politizoj sepse ai vet e potencoj se janë dy të mira që i keni bërë, 1-vizitat e bëra në terren dhe 2-pjesëmarrja në Kuvend, mirëpo unë e them që më së paku janë të mira këto sepse ka pasë shumë masa dhe veprime konkrete që kemi marrë e për të cilat duhet të krenohemi por unë nuk krenohem e që as ju nuk do të duhej të krenoheni sepse krenarinë e vlerësojnë të tjerët.

Pra shumë problematika që u ngritën janë të ndërlidhura me Qeverinë përkatësisht me Ministri dhe institucione të ndryshme siç është edhe Agjensioni për Zhvillim Rajonal, mirëpo me një bashkëpunim dhe bashkëfinancim besoj që do të zgjidhen këto problematika, shembull, siç ishte ndërtimi i urës në fshatin Lupç.

z.Vezir Januzi, drejtoi i DBPZHR, theksoi, po më vije mirë sepse vërtetë po zhvillohet një debat i frytshëm sot dhe kishte me qenë mirë që në Komunën e Podujevës këso debatesh dhe takimesh të kemi më shpesh sepse siç e dini Bujqësia është shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës. Është mirë që më në fund të gjithë po e shohim se duhet kthyer kokën kah bujqësia.

Nuk dëshiroj të ndalem rreth subvencioneve sepse listat janë publike por kur do që dëshironi unë mund t'ju sjellë edhe këtu dhe t'ju prezantoj të gjitha listat e fermerëve përfitues ngase nuk kemi çfarë të fshehim mirëpo janë ndihmuar çdo herë fermerët që e kanë merituar me përjashtime eventuale sepse mund të ndodh që në 100 fermer përfitues të mos ndonjë. Arsyeja përse ndahen subvencionet në shesh apo në Palestra sportive është sepse do të ishte ngarkesë për fermerët dhe operatorin që t'i dërgojmë fermerët në një Komunë tjetër ta zëmë, për t'i marrë pajisjet apo donacionin që ka përfituar, ndërsa ka subvencione për të cilat nuk praktikohet një gjë e tillë, shembull, serrat ju ndërtohen fermerëve nëpër vende ku ata i kanë caktuar dhe nuk kemi nevojë t'i thërrasim në shesh, prandaj për këtë arsye caktohet një ditë kur iu shpërndahen ato mjete e që mund të merrni pjesë edhe ju dhe të shihni secilin fermer përfitues, kurrfarë problemi nuk është, kështu që unë nuk e paraqes si shqetësim këtë punë. Çështja e zgjedhjes së këtij problemi për të cilin po diskutojmë e që është shumë i rëndësishëm për projektet në bujqësi që janë të miratuara nga Kuvendi i Komunës edhe pse jemi në kohë pandemie ato projekte janë duke u zhvilluar, pra iu kemi qëndruar afër fermerëve sepse pandemia Covid-19, ka bërë të veten ku në disa raste ka qenë e pamundur që fermerët të jenë shpesh nëpër tokat e tyre, kështu që projektet janë duke u zhvilluar, thuajse të gjitha projektet që kanë qenë të parapara për këtë vit janë bërë shpalljet publike, disa janë shpërndarë, disa janë në proces dhe për disa do të zhvillohen procedura nga ne si Drejtori, mirëpo me buxhetin e ndarë që kemi për këtë sektor nuk kemi kurrfarë mundësie që ta orientojmë për çështje tjera.

Kërkoj nga secili prej juve i cili mund të ketë ndonjë ndikim në Institucionet qendrore që të ndikojmë sepse veç se ka filluar kompensimi i dëmeve dhe janë në proces e besoj se fermerët e dëmtuar të kompensohen për dëmet e shkaktuara, dëshira ime është që 100% të kompensohen, por është ndarë dhe miratuar nga Qeveria që vetëm 25% e dëmeve të kompensohet, unë nuk mund ta rrisë atë përqindje, kështu kjo që thashë është e vërtetë që Qeveria ndan fonde dhe e paraqita si kërkesë time personale ndarjen e një fondi të veçantë. Unë në muajin shtator gjatë procesit të hartimit të buxhetit do të paraqesë kërkesat dhe do të kërkoj edhe nga ju si Kuvend që të futet dhe përkrahet një kod i ri buxhetor sikurse që është shembull, ndërtimi i serrave në shumë 100,000.00€, të ndajmë buxhet, pastaj e regjistrojmë edhe si kod buxhetor në të cilin planifikojmë 100,000.00€, apo 200,000.00€ për vitin 2021 për kompensimin e dëmeve.

I nderuar **z.Rafet Llapashtica** ne nuk e kemi ditë që këtë vit do të shfaqet pandemia Covid-19, pastaj **z.Pajtimi Hodolli** bëri pyetje se a është kompensuar ndonjëherë dëmet, po është e vërtetë se janë kompensuar në vitet 2015 dhe 2016, unë kam qenë Zëvendësministër në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillit Rural dhe është ndarë një kod i veçantë për dëmet e shkaktuara në bujqësi, drejtor i DBPZHR ka qenë **z.Avni Fetahu** i cili besoj se është në dijeni se janë ndarë mjete për kompensimin e 25% të dëmeve të vlerësuar për Komunën e Podujevës. Konsideroj se mënyra më e mirë për ta tejkaluar këtë situatë është që edhe ju prej këndit t'juaj, ku do që mundeni të keni ndikim në Institucionet qendrore, mirëpo unë si drejtor i DBPZHR duke i prirë kësaj nisme për ta ngritë zërin për kompensimin e dëmeve sipas raporteve të Komisionit përkatës të Komunës në mënyrë që fermerët e dëmtuar të kompensohen. Pra unë po foli në kontekst të raporteve dhe programeve të DBPZHR, ndërsa për çështje tjera të Drejtorive tjera siç ishte rasti për buxhet do të ishte mirë po të ishte prezent edhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për të dhënë sqarime dhe çështje

tjera të nevojshme. Gjithashtu do të ishte mirë që të gjithë asamblastët të jeni zë i fuqishëm i qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe ju sugjeroj të vizitoni lokalitetet e dëmtuara sepse vërtetë nëse i shihni me sy dhe i prekni ato kultura bujqësore të dëmtuara besoni se nuk do të politizoni në këtë çështje aspak, por do të jeni shumë të shqetësuar për situatën çfarë është në terren, pra është mirë që të gjithë të dilni në terren sepse të gjithë jeni qytetarë të Komunës së Podujevës, të vizitohen fermerët sepse jemi të obliguar të japim raport para qytetarëve të Komunës së Podujevës për gjithçka çka ndodhë në Komunën e Podujevës.

E përsërisë, për çështjen e ndarjes së subvencioneve, kur do që dëshironi unë si drejtor i DBPZHR do t'ju sjell me emër dhe mbiemër listat e përfituesve, si dhe nga këtu edhe njëherë po ju them që nuk ka ndarje të subvencioneve në baza partiake ashtu si mendoni.

z.Bajram Ajeti, theksoi, po e krahasoi këtë raport me atë raportin që asnjëherë nuk na e sollët, ndoshta ju kujtohet zotëri Vezir që në një seancë të jashtëzakonshme kur unë shfletoja fotografitë e dëmeve nga vërshimet që u bënë në disa fshatra që ishin dëme të mëdha, atëherë kur liqeni i Batllavës ishte i mbushur me ujë mbi nivelin maksimal, kurse këtu na u tha se komisioni është në terren mirëpo kurrë nuk është prezantuar dhe asnjëherë nuk patëm raport e as informata se a është kompensuar ndokush. Në atë kohë kishte ekonomi familjare të dëmtuara, kishte bagëti të ngordhura, gypat e rrjetit të kanalizimit të fshatit Batllavë ishin bartur nga vërshimet në fshatin Gërdoc dhe ato fotografi i pata prezantua para jush, andaj kjo na bënë që të dyshojmë që ju edhe kësaj radhe nuk keni komision sepse nuk jeni në gjendje ta prezantoni atë, ndërsa në qoftë se nuk e keni komisionin formalisht të formuar atëherë ju mund të shkoni si vijon, informatat i merrni nga kryetari i degës së LDK-së që është i pa ligjshëm, i cili për NN fshatin thotë, shiko Vezir se në NN fshatin njërit iu kanë bërë disa dëme, këqyr bë diçka për të. Kam bindjen se është logjika juaj kështu është menduar të veprohet kështu andaj jam duke fol për dëmet e shkaktuara nga vërshimet që nuk keni bërë asgjë as ju e as këta para sa viteve më duket në vitin 2018.

Kryesues i Kuvendit, kërkon nga z.Bajram Ajeti të kthehet në temë dhe mos të akuzoni sepse vërtetë janë bërë punë mjaftë të mëdha në këtë drejtim siç është pastrimi i lumenjve etj andaj të lutem mos politizo, kthehuni në temën për të cilën jeni thirrur.

z.Bajram Ajeti, vazhdoi, të nderuar këtu vërtetë u dhanë disa mendime, disa mënyra të një përfundimi të një seance që ka të bëjë me një hall të qytetarëve që duhet të na preokupojë të gjithëve, por pas deklaratave po shihet se nuk po na preokuponë të gjithëve por preokupimi do të materializohet atëherë kur qytetari apo fermeri do të ndihmohet drejtpërdrejtë, kështu që unë pajtohem edhe me ata që dhanë mendime, shembull asamblastja znj.Fatlume Jaha dha propozime, rekomandime dhe përfundime, si dhe deklarata që na propozoi z.Pajtim Balaj, e që mendoj se ka shumë pika kyçe dhe shumë të rëndësishme, mandej edhe drejtori i DBPZHR bërë një apo dy, kështu që unë mendoj që mos të dalim pa asnjë përfundim apo konkluzion sikurse nga ajo seanca atëherë, por është mirë që shefat e Grupeve të këshilltarëve ta mbajnë një takim të shkurtër dhe të dalin me një konkluzion, qëndrim deklaratë apo çfarëdo që të jetë, por të jetë rezultat i kësaj mbledhje. Përndryshe unë pajtohem me atë se mbledhje të tilla të iniciura pastaj po dalin vetëm sa për mëditje apo diçka tjetër, por vërtetë nëse sjellim ndonjë dokument nga kjo seancë unë mendoj se atëherë e kemi merituar edhe mbajtjen e seancës, përndryshe veç të thirret seanca dhe të mos nxjerrët një konkluzion, qëndrim apo vendim lidhur me interesin qytetarë, mendoj që nuk është mirë.

Kështu që propozimi ekzistoi dhe besoi që kemi mjaftë qëndrime nga të cilat mund të nxjerrim një konkluzion nga kjo mbledhje dhe të dalim para opinionit publik dhe para qytetarëve.

znj.Doruntinë Hasani, theksoi, këtu po dëgjoj gjithëherë fjalën politizim prej drejtorit të DBPZHR në çdo seancë po thuajse, çka do që themi ne për qytetarët ose që vjen si shqetësim këtu thuhet që është politizim, nuk e di njëjtë si përfaqësues të LVV-se, të LDK-së, PDK-së dhe partive tjera të

gjithë jemi përfaqësues në Kuvend dhe këtu kemi ardhë me i paraqit problemet e qytetarëve kështu që politizim bëri shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, pa i pyetur asnjë për mendimin deklaroi se ne nuk e mbështesim deklaratën kurse znj.Fatlume Jaha të gjitha ato që i tha në deklaratë i mbështeti, pothuajse gjëra të njëjta, nuk e di me këtë fjalën politizim jeni duke e tepruar.

Sa i përket drejtorit Vezir Januzi, vetëm të na ftoj se edhe ne do vijmë me kënaqësi, por nuk na keni ftuar kurrë asnjëherë as në debate publike madje, kështu që ne me kënaqësi do vijmë nëse ftohemi.

z.Vezir Januzi, drejtor i DBPZHR, theksoi, vetëm një replikë me z.Bajram Ajeti rreth komisioni Komunal, Komisionin e ngrit Kryetari i Komunës për një mandat tre vjeçar. Komisioni është i ngritur dhe përbëhet nga tri drejtori, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sa për njoftim Komisioni është i ngritur në këtë përbërje, Avni Syla kryesues, Naime Ajeti, sekretare, Xhafer Sekiraça, anëtar Ismet Kadriu, anëtar dhe Kujtim Zhitia anëtar, komisioni i cili është duke e kryer punën e vet, singërisht për secilin fermer që është i dëmtuar kemi raport veç e veç që nga muaji janar e deri më sot.

Edhe njëherë po e përsërisë më ndihmoni mua si drejtor i DBPZHR, jam shumë i kënaqur që mora opinione këshilla të ndryshme gjatë këtij debati por t'i shtyjmë përpara këto dhe fermerët të përfitojnë kjo sepse është e një rëndësie të veçantë.

z.Avni Fetahu, theksoi, u mundova të mos flasë në këtë seancë por meqenëse mu referua emri po e ndjej obligim të sqaroj një pozicion, është e vërtetë ajo që tha drejtori i DBPZHR se në vitin 2016 ka qenë një kompensim për dëmet dhe ajo vlerë ka qenë 14,950.00€, vlerë e cila ka qenë prej projekteve më të vështira që kam mundur të realizoj për arsye se deklarimi i dëmit pat arritur gati vlerën 1 milion euro, ndërsa ne atë vlerë prej 14,950.00€ nuk kemi ditur se ku ta ndajmë, kështu që konsideroj që nuk do të vij ajo vlerë prej Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural siç ka ardhë atëherë në fund të muajit dhjetor për shkak që mjetet i kanë ndarë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve por të vjen me kohë.

Një element tjetër çka më ra në sy është se më herët nuk ka qenë ky aneksi, konsideroj dhe do të jeni të bindur më vonë sepse jemi dëshmitar këtu që aneksi i bashkangjitur tani e ka një “bisht” të caktuar kështu që kisha dashur të realizohet në mënyrë të përpiktë kompensimi i dëmeve dhe jo me anekse për arsye se e vështirëson punën dhe krijon paqartësi.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, pikë së pari dua ta marrë si pozitive dhe jam e prirë të mendoj në atë mënyrë, referencat që i bënë dy kolegët nga LVV-ja për mua i falënderoj që e vlerësuan atë që unë thash, por për ta qartësuar për hir të qytetarëve dhe kolegëve dhe të gjithëve, unë në fjalimin tim e thash që kjo seancë të dal me një përfundim dhe me dy rekomandime, unë isha e qartë me atë që e thashë prandaj arsyeja se dola për ta sqaruar këtu është që unë nuk përkraha asnjë deklaratë apo ndonjë vendim të dikujt, ishte një propozim i imi personal dhe e ceka se është mendimi im personal për propozimin të cilin e bëra. Çfarëdo tendence për ta ofruar me ndonjë propozim apo deklaratë, besoj që fjala ime ishte shumë e qartë dhe mendimi ishte puro personal në shërbim të qytetarëve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, vendimi faktikisht u dha për arsye se, sa kuptova unë drejtori e tha që nuk ka bazë ligjore të bëhet kompensimi i dëmeve, dua të them se ne jemi të qartësuar se Komuna nuk ka hapësirë ligjore të bëjë kompensimin e dëmeve. Problem tjetër është kompensimi jashtë ligjor i vitit 2014 nga ish Drejtori z.Avni Fetahu që tha i kemi kompensuar në shumë rreth 14.000,00€, pra si i keni kompensuar me ato mjete pasi që nuk ka hapësirë ligjore as tani.

Vendimet e Kuvendit nuk gjykohen por vetëm mund të kthehen si vendime jashtëligjore dhe të kthehen në rishqyrtim, ne si Kuvend askush nuk mundet të inicioj procedurë gjyqësore por organet qendrore e kthejnë vendimin prapa, andaj nëse është ai vendim jashtëligjor këtë verdikt ta jep Ministria. Me 25% të dëmeve të vlerësuar i subvencionon niveli qendrorë/MBPZHR, shuma që është

ndarë e miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës është 3,000,000.00€ për këtë linjë buxhetore në bazë të këtyre dokumentacioneve. Nga kjo shumë janë ndarë 1,100,000.00€ për Komunën e Suharekës, jemi dëshmitarë të gjithë për vërshimet, kanë mbetur edhe pjesa tjetër e kësaj shume të shpërndahet nga shuma prej 3,000,000.00€ që të bëhet ndarja në 25%, pra i bie shuma prej 120,000.00€, kurse ne tani nuk mund ta dimë se sa komuna kanë pasë dëme dhe vërshime, pastaj sa buxhet do të ndajë Ministria për Komunën e Podujevës nga kjo shumë e mbetur që është.

Edhe këtë shumën prej 3,000,000.00€ nëse e pjesëtojmë me 25% del shuma prej 120,000.00€ të cilat po ti ndaheshin Komunës së Podujevës, apo vetëm 12,000.00€ duhet ta dimë saktë në mënyrë që pastaj t’iu shpërndahen ato mjete, ta zëmë 12 fermerëve për dëmet e shkaktuara, pra vetëm për këtë temë ne mund të diskutojmë.

Sa i përket harmonizimeve se kush çka tha, unë apo ai, dhe se a është deklarata e “Pavarësisë” apo e LVV-së apo e znj.Fatlume Jaha, është çështje tjetër, deklarata e vetme është që komuna nuk ka mundësi të mbështet asnjë fermer për dëmet e shkaktuara si pasojë e breshëritë dhe vërshimeve, pra kjo është deklarata e DBPZHR.

Deklarata e dytë ishte që drejtori i DBPZHR do ta sjellë buxhetin për miratim në këtë Kuvend për këtë çështje, mirëpo betohuni ju që kur të vije rishikimi i buxhetit mos ta miratoni në Kuvend apo ju znj.Fatlume Jaha deklarohuni që nuk e mbështeteni atë buxhet ashtu siç do të propozohet sepse nuk mund t’i ndihmoni fermerët. Madje keni qenë në Grup parlamentar dhe nuk na është sjellë fare plani i punës kur është paraparë miratimi i buxhetit, e kemi pritur 3 ditë drejtorin që të vije dhe nuk ka ardh fare, pastaj kemi marrë vendim në KPF që asnjë dokument mos të kaloj pa u bërë plani i prokurimit dhe prapë e keni votuar, politikë është ajo kurse unë nuk e votoj sepse njëherë vendosi për diçka. Pra i nderuar zotësi Kryesues i Kuvendit ju jeni shef i Kuvendit dhe e respektoj këtë pozicion, të sugjeroj ta përmbyllni këtë seancë me një konkluzion sepse në bazë të asaj çka dëgjuam komuna nuk ka hapësirë të mbështet askënd sepse nuk ka hapësirë ligjore, e dyta duhet që me hapa të përshpejtuar të shikohet që nga shuma e mbetur të mundësohet ndarja e buxhetit për kompensimin e fermerëve në shumën prej 25%, t’i bëhet presion MBPZHR, e treta në muajin shtator kur të bëhet rishikimi i buxhetit sërish po ju them që nga të hyrat vetanake nuk ka ligj që e dënon shpërndarjen e të hyrave vetanake qoftë për subvencionim, qoftë për kompensim, qoftë për ndihmë humanitare, e që ne i kemi rreth 2 milion euro të hyra vetanake e që ne e dimë se si i keni subvencionuar deri dhe e dimë e ka paraparë ekzekutivi këtë shumë për subvencione.

Nëse tani drejtori i ndanë të gjitha të hyrat vetanake për këtë çështje, pastë ligj që e procedon për vepër penale, unë jap llogari personale dhe familjare sepse ashtu e ka parapa ligji, madje nëse për 30 vite i mbledhim 60 milion euro nga të hyrat ato aty do të mbesin deri sa të nënshkruan Kryetari i Komunës se ku do të shpenzohen, prandaj nuk kemi çfarë të diskutojmë këtu më por po të sugjeroj ta mbyllni këtë seancë. Merreni vendimet vet e mos e ngrisni dorën pro vetëm politikisht sepse të gjithë këtu përfaqësojmë subjekte politike, por mos te ngrisim dorën e të votojmë politikisht.

z.Vezir Januzi, drejtoi i DBPZHR, theksoi, z.Rafet Llapashtica, të dëgjova kur the se drejtori i DBPZHR po thotë se nuk mundemi dhe nuk kemi mundësi t’i ndihmojmë fermerët. Fermerët po në vazhdimësi po ndihmohen dhe po e them sinqerisht se komuna jonë është komuna e vetme që mund të merret shembull për përkrahjen e fermerëve. Çështja është se ju e keni ngatërruar ndihmën me subvencione lidhur me kompensimin e dëmeve, këto janë dy çështje që i ngriti edhe z.Avni Fetahu që nuk duhet ngatërruar projektet e miratuara nga Kuvendi i Komunës për DBPZHR, pra kanë kaluar përmes Kuvendit Komunal dhe janë projekte që po i shohin dhe po i prekin fermerët Llapjan.

Sa për rikujtim tuaj zotëri Llapashtica, vetëm këtë vit janë duke u ndërtuar 115 serra, kanë përfituar 65 fermer sistem të ujitjes pikë-pikë e ka edhe fermer që janë dëmtuar, normalisht me participim

sepse ju po i dini problemet se si janë sepse janë mësuar disa njerëz që nuk e punojnë fare tokën dhe aplikojnë për subvencione duke u thirrë në atë se Komuna po jap subvencione falë.

Fermeri që është fermer nuk e shikon 30% të participimit, dhe kjo është në anën pozitive të fermerit dy herë sepse edhe po e rritë mundësinë që të përfitojnë më shumë fermer po edhe eliminohen ata që janë jo real dhe po mendojnë që duhet me marrë subvencione veç falë ashtu, kështu që participimi ka ndikuar pozitivisht sepse kemi raste kur shpallen konkurse publike për programe, nuk plotësohet numri i atyre që kemi me ju ndihmuar sepse janë eliminuar ata individ që kanë menduar se Komuna po jep subvencione falë, dhe me i keqpërdorë mjetet e ndara, çështje të cilën e pati ngritë më herët vet këshilltari z.Rafet Llapashtica. Kjo ka pasë efektin direkt te ata fermer që janë të vërtetë që kanë punuar por sot ata që participojnë e që gjithkund në botë është participimi, jo nuk qëndron ajo që po thuhet nga vendi se i shesin, sepse nuk e besoj që ndokush participin shembull në një serrë dhe atë e shet dhe e shet. Edhe njëherë po e them dhe nuk tërhiqem nga ajo që e thash në fillim që në muajin shtator kur e kemi miratimin e buxhetit të gjejmë një kompromis në bazë të rregulloreve dhe ligjeve në fuqi nëse na lejohet dhe të vendosim një kod dhe pastaj bashkërisht të shohim sa kemi mundësi dhe hapësirë prej të hyrave vetanake nga taksapaguesit e Komunës së Podujevës t'i ndajmë qofshin ato 100,000.00€ apo 300,000.00€, por asnjëherë mos ta komplikojmë situatën me subvencione të cilat janë të parapara për bujqit sepse jemi të gjithë për t'i ndihmuar.

Unë po them se do ti bëjë presion maksimal Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, madje para rreth 10 ditëve Ministri i kësaj Ministrie ka dalë ne terren dhe i ka parë dëmet e shkaktuara te fermerët dhe ka marrë obligime që do t'i shtyjë këto procese. Pra nuk qëndron ajo kinse nuk kanë prek subvencionet apo kompensimet e dëmeve sepse shumë mirë i paraqita në fillim se 17,330.00€ nëse nuk gaboj në shumë janë ndarë kompensim të dëmeve kurse pjesa e dytë që është dërguar raporti i dytë në Ministri veç se janë në procedurë që kompensimet t'i dalin fermerëve në llogaritë e tyre, ndërsa për pjesët tjera do të bëjmë presion të gjithë së bashku dhe ta zgjedhim këtë problem. Nuk është mundësia që sot për sot të themi por unë si drejtor po e marr për obligim para juve që do të bëjë një zgjidhje që fermerëve t'iu mbulohen dëmet prej Komune plus 25% në mënyrë që të arritet kompensimi në 50% dhe për këtë arsye edhe jemi takuar të bashkëbisedojmë dhe të gjejmë një modus mirëkuptimi që vërtetë të ndihmohen fermerët ashtu siç e meritojnë.

Nuk jam unë këtu i nderuar z.Rafet Llapashtica që mos të ndihmohen fermerët, sinqerisht jua them, mirëpo punët tona vazhdojnë dhe meqë që kjo seancë është e thirr për këtë temë unë po ju them aq sa di dhe aq sa mundem, do të jem transparent para jush. Dikush nga parafolësit paraqiti si shqetësim ngritjen e pendave e që është projekt për herë të parë që zhvillohet nga Komuna e Podujevës, mirëpo unë ju them se për këtë na e kanë lakminë edhe komunat tjera sepse janë ndërtuar me standarde, pra kemi filluar me ngritjen e dy pendave në fshatin Metehi dhe kemi vazhduar me ngritjen edhe të dy të tjera në fshatin Dobërdol, penda që ka qenë shumë të nevojshme dhe të domosdoshme sepse ju e dini se si kanë qenë pendat e ngritura më herët në fshatin Repë, dhe këtë vit i kemi në projekt ngritjen e dy pendave në fshatin Lupç që janë mbi 80 ha kultura perimtarie dhe që ujiten me atë ujë e që mendojmë se edhe ju e shihni të arsyeshme që ky projekt të vazhdoj sepse kemi kërkesa edhe në fshatin Popovë si dhe kërkesa tjera përgjatë shtrirjes së lumit Llap, prandaj siç jemi në dijeni që kohë pas kohe po ka thatësira të mëdha dhe aty ku e shihni si të nevojshme dhe të arsyeshme pse mos të ngriten penda të tilla. Lumi Llap rrjedh prej pjesës veriore dhe nuk kemi mundur të ndërtojmë penda atje ku s'ka ujë por ne i kemi ndërtuar aty ku buron uji dhe aty ku fermeri preket direkt nga ai burim. Edhe njëherë ju falënderoj shumë sepse sinqerisht jam shumë i kënaqur me debatin që u zhvilluar dhe kërkoj nga ju aty ku keni mundësi gjithmonë të ndikoni që të ndahen mjete për kompensimin e dëmeve për dëmet e shkaktuara fermerëve të Komunës së Podujevës, por me

shpresën që nga buxheti i ndarë nga Qeveria do të ketë mjete që do të ndahen edhe për Komunën e Podujevës.

z.Hasan Ajeti, theksoi, drejtori i DBPZHR z.Vezir Januzi na njoftoi për takimin me Ministrin e MBPZHR, është formuar një komision në kuadër të kompetencave të nënkryetarit respektivisht kryetarit në detyrë, ai komision i ka verifikuar dëmet dhe ato lista i nderuar zotëri Januzi a janë dërguar në Ministri, në fakt ju e cekët që po, mirëpo tani sa është numri i sakti i fermerëve mund të na tregoni.

Më herët diskutuam rreth çështjes juridike se a kemi apo jo të drejtë, dhe çështjen tjetër rreth mundësive buxhetore se a ka apo jo mundësi e që këtu u tha që nuk ka një kod, një kategori të veçantë dhe as nuk ka pasë deri sot. Prandaj edhe njëherë z.Vezir Januzi dil këtu në foltore dhe sqaroje se sa është numri i atyre që dokumentacionet i kanë shkuar Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe kur përafërsisht konkretisht që ata fermerë të jenë përfitues të asaj ndihme të Ministrisë, kurse sa i përket temave tjera ne veç se i diskutuam.

z.Vezir Januzi, drejtoi i DBPZHR, theksoi, nëse dëshironi me numra dhe emra ju tregoj që të gjitha sepse këtu me vete i kam, shkresa e parë që iu është dërguar nga Nënkyetari i Komunës në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është me datën 22 prill 2020 dhe dëmet e vlerësuara në kulturat bujqësore janë në vlerë rreth 21,415.00€, fermer të dëmtuar janë 12, pastaj kemi shkresën tjetër të datës 29 maj 2020 me dëme të shkaktuara në vlerë rreth 17,333.00€ që është miratuar nga Ministria e Bujqësisë dhe janë në procedurë ku afati i fundit ka qenë 22 korrik 2020 që DBPZHR dhe Nënkyetari i Komunës t'i dërgojmë raportet në Ministrinë e Financave dhe tani pritet që mjetet prej 25% t'i u dalin në llogarit e fermerëve, bëhet fjalë për 15 fermerë dhe këtu kemi raportet për secilin. Me datën 09 korrik 2020 është dërguar shkresa e radhës ku dëmet e shkaktuara sipas raporteve arrijnë vlerën 98,443.00€, numri i fermerëve të dëmtuar që janë paraqitur në zyrat e Komunës është 38, kurse z.Avni Fetahu e ngriti si çështje raportin shtesë/aneks, fjala është për disa fermerë të cilët kanë presuar dëme nga fatkeqësi të ndryshme natyrore por që për shkak të kufizimit të lëvizjes që ka qenë në fillim të pandemisë por edhe për shkaqe që nuk kanë qenë në dijeni për kompensimin e dëmeve nuk kanë paraqitur kërkesat e tyre për vlerësim të dëmeve, sa për njoftim tuajin janë dy fermerë që i njohë personalisht dhe që besoj se edhe ju i njihni të cilët merren me kultivimin e boronicës (Lum Hoxha që është kultivues i 12 hektarëve dhe Yll Hoxha) të cilët më besoni që përveç frutit që iu është dëmtuar është dëmtuar edhe komplet edhe fidanishtja e që nuk besoi që vitin tjetër do të kenë mundësi ta ngritin prodhimin sërish dhe kërkesat e tyre i kemi pranuar pastaj pavarësisht që siç jeni në dijeni është një afat kur duhet fermerët të aplikojnë për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve. Nënkyetari i Komunës gjegjësisht iu ka dhënë mundësi atyre dhe disa fermerëve tjerë përfshirë edhe fermerin Ekrem Rrahmani në mënyrë që për shkak të pandemisë që nuk kanë mundur me kohë të aplikojnë për kompensim të dëmeve e që pastaj më 20 korrik 2020 është dërguar shkresa e radhës ku përveç dëmeve tjera për fermerë tjerë janë përfshirë me raport aneks edhe këta 12 fermer, shuma e këtij aneksi nëse nuk gabohem është rreth 193,000.00€.

për pjesën tjetër të dëmeve deri sot kur unë erdha në këtë seancë numri i aplikacioneve të fermerëve të dëmtuar nga breshëri i datës 18 Korrik 2020 është 68 aplikues dhe besoj se do të ketë edhe të tjerë, kurse komisionet janë në terren dhe për çdo detal do të informoheni e që menjëherë po sa ta përfundojmë vlerësimin në terren do të përgatitet raporti përmbledhës dhe do t'i drejtohem sërish Ministrisë për kompensimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë, madje unë personalisht po ju premtoj se ditën e hënë do të shkoj në zyrën e Ministrit të MBPZHR me të gjitha këto raporte edhe pse janë dërguar zyrtarisht në Ministri, por që edhe njëherë unë do të kërkoj sepse nuk guxon që pjesa e parë e dëmeve të raportit 22 prillit 2020 të anashkalohet dhe të fillohet me pjesën e dytë kështu që do të kërkoj dhe do jem këmbëngulës në qëndrimet tona.

z.Avni Islami, theksoi, zotëri Kryesues i Kuvendit unë kam një propozim për shkak se ne po vijmë këtu të pa përgatitur, me përjashtim të një grupi të vogël që diskutuan për një problematikë të veçantë. Në rastin konkret drejtori i DBPZHR do të duhej që secilit nga ne të na i dërgoi raportet dhe të na i tregoj qoftë brengat qoftë dëmet materiale në mënyrë elektronike që secili ta kem të qartë kur të vijmë në mbledhje, ta dimë se për çka është fjala, shembull, drejtori për këtë çështje të ngritur i tregoj shifrat, i dha numrat por unë i harroj si të dal prej këtu sepse secili nga ne ka nevojë me i marrë ato dhe me i analizuar kur të vij këtu unë apo secili prej nesh dalim me qëndrime, kështu që është mirë që në mënyrë gjeneralë, atij që është përgjegjës për email-e ju drejtor t'ia përcjellni shqetësimet ose vizitat që i keni bërë, më konkretisht vizitat në lokalitetet ku janë bërë vërshimet sepse ju keni bërë një raport dhe të njëjtin raport t'ua përcjellni atyre që janë përgjegjës në mënyrë që ne të na vijë në mënyrë elektronike që kur të vijmë në Kuvend të jemi më të përgatitur dhe të ngritët niveli i bisedës.

z.Avni Fetahu, theksoi, kërkoj mirëkuptimin për një sqarim për z.Rafet Llapashtica, me mirëkuptimin më të madh që mjetet të cilat u potencuan nga MBPZHR janë ndarë në formë të rregullt, nuk kanë qenë ndarë në formë të jashtëligjshme, e njëjta gjë do të bëhet edhe për këto të tanishmet. Këtu u paraqitë një deklaratë dhe pat propozime të mira nga të gjitha subjektet politike, por e gjitha çka mbetet është 5 ose 10 minuta kohë që të harmonizohen dhe të dilet me një propozim konkret e që ne ashtu tregojmë se a dëshirojmë t'ju ndihmojmë fermerëve, po ose jo.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, qëndrimi i shefit të Grupit të LDK-së ishte që për këto brenga dhe shqetësime të merret drejtoria përkatëse dhe të hulumtojë për të gjitha mundësitë reale buxhetore që përveç kompensimit të dëmeve prej 25% nga MBPZHR, 25% e dëmeve të të kompensohen edhe kuadër të mundësive buxhetore të Komunës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, këtu kemi dy çështje, ose po dëshirojmë ne të merremi vesh për këtë çështje ose nuk po dëshirojmë. Është mirë që ta kenë një takim shefat e Grupeve të subjekteve politike në këtë Kuvend, të konsultohen dhe të gjejnë një zgjidhje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, sqarime parafolësit, nuk po dësjiroj ta hedh në votim këtë çështje para se të dilet me një konkluzion të përbashkët për këtë temë e cila konsideroj se është mjaft serioze. Pra nëse ka interesim urdhëroni shefat e Grupeve mund të konsultoheni dhe të paraqitni një qëndrim përfundimtarë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, së pari z.Rafet Llapashtica nuk është shef i Grupit të PDK-së, qëndrimi i Grupit të LDK-së është shumë konkret, unë e theksova edhe në diskutimin tim të mëparshëm, pastaj drejtori i DBPZHR e tregoj procedurën komplet prej fillimi deri në fund dhe e ceku që ende janë në përfundim të përmbledhjes së dokumentacionit për fermerët e dëmtuar nga breshëri dhe vërshimet. Çështja tjetër, është mundësia në bazë të vendimit të Qeverisë që 25% e dëmeve të shkaktuara t'iu dalin si ndihmë fermerëve, se sa është mundësia të përfshihen unë nuk mund ta dijë por është drejtori ai i cili konkretisht mund të jetë në dijeni.

Sa i përket temave tjera zotëri Llapashtica nuk është këtu prezent për momentin, por nuk ka nevojë askush të flasë në emrin tim, sepse nuk është i thirrur për atë punë, andaj unë nuk kam pse të bisedojë me askënd për këtë çështje sepse këtu prezent është personi i autorizuar që në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve është i thirrur për çështje. Na u bë e ditur që nuk ka një kod buxhetor për t'i ndihmuar këtë kategori dhe unë nuk e kuptoj se çfarë kemi për të diskutuar më shumë për këtë temë. Askush nga ne nuk është për mos t'iu dalë në ndihmë fermerëve të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore të ndryshme.

z.Bajram Ajeti, theksoi, këtu u ballafaquan ata të cilët kanë qenë dhe kanë parë gjendjen të cilën e kanë shkaktuar vërshimet dhe besoj që ka mjaft asamblist, nuk e di nga LDK a keni qenë ndokush apo vetëm drejtori përmes komisionit siç tha, mirëpo mua më duket ose nuk po e kuptojnë këtu se

çështja e vërshimeve të datës 18 korrik 2020 është në procedim e sipër sepse është faza e aplikimit, mirëpo edhe opozita në këtë rast por edhe pozita po më duket me dilema e cila përmes z.Hasan Ajetit kërkohet të nxirret menjëherë një konkluzion ose përfundim me qëllim që ne ta ndihmojmë Ekzekutivin dhe që pastaj në të ardhmen në situata të tilla zgjidhja të gjendet më lehtë, a ka mundësi, po ka mundësi. Unë po dëshiroj që kur të vie çështja e rishikimit të buxhetit mos të kemi ndarje por këtë çështje ta mbrojmë gjithë së bashku për krijimin e një fondi të veçantë apo kod buxhetor si do që të quhet ai dhe duke parashikuar edhe bazën ligjore në mënyrë që pastaj të mos ketë ndasi me rastin e votimit, pra ky është qëllimi, por që fundja procedurat duhet ti ndjekim, ndërsa rreth asaj asaj se a ka përgjegjësi drejtorja përkatëse, a e ka krye punën mirë apo jo deri tani, a ka defekte, a ka shkelje procedurash, a ka motivim politik, a ka papërgjegjshmëri, janë çështje të cilat na duhen neve edhe një kohë e gjatë. Nuk është në pyetje se politika ta përcakton edhe zhvillimin ekonomik edhe të bujqësisë dhe të çdo gjëje, jeni mësuar verbërisht të thoni politikë-politikë, por ju duhet ta dini që politika përcakton zhvillimin ekonomik në këtë rast edhe bujqësinë, tani me politika zhvillimore mund të kemi dallime këtu ama ta thuash veç ashtu politika-politika kjo mendoj që nuk është e drejtë sepse politikat merren me çështjen e trajtimit të problemeve të qytetarëve për të cilën gjë jemi mbledhë edhe sot, prandaj mendoj që nuk prishë punë që ndoshta një propozim që ishte i drejtorit të DBPZHR, një i një Grupi tjetër, një i tjetrit e kështu me radhë të vihen si përfundime të kësaj mbledhje dhe mos të tregohemi aq të ligë, aq të pa dijsëm që të dalim nga kjo sallë nga kjo sallë pas 2 ose 3 orësh dhe mos të kemi diçka dhe të lëmë ndonjë dokument që nesër do t'na obligojë edhe ne si asamblast por do të obligojë realisht edhe Ekzekutivin të zbatojë vendimet që i merr, në këtë rast një qëndrim apo një konkluzion që merr asambleja.

z.Vezir Januzi, drejtoi i DBPZHR, theksoi, vërtetë kemi biseduar gjatë këtu dhe të gjithë e kemi një qëllim por për me dalë prej kësaj seance pa një qëndrim dhe një vendim mua dhe secilit i duket që nuk është normale, kështu që unë disa here ngrita dhe potencova para jush por edhe njëherë po i potencoj dhe propozoj dy qëndrimet tona që duhet të thirremi sot nga kjo seancë e cila tani veç po dihet për çka është thirr e që duhet ti tingëlloj në vesh edhe Ministrin të MBPZHR por edhe Qeverisë për çka jemi takuar, e para, pra që është thirr kjo seancë për dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore, e që pas Komunës së Rahovecit ne jemi Komuna më e prekur nga dëmet e shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet. Në fillim e thashë dhe po e them sërish dhe asnjëherë nuk tërhiqem sepse në bazë të programeve që i kam si Drejtori për vitin 2021 do të jetë pjesë e buxhetit edhe subvencione për dëme në bujqësi sepse në bazë të ligjeve në fuqi kod të veçantë buxhetor nuk mund të kemi. Pra këtu dy gjëra propozoj të jenë si përfundime nga kjo seancë, e që nga muaji shtator besoj se një vendim të tillë edhe fermerët do ta mirëpresin.

Kur do që ndalemi dhe i ndihmojmë fermerët është në interesin e tyre dhe qytetarëve të Komunës së Podujevës sepse edhe unë do të dëshiroja që në vitet 2010/2011 të gjenim mundësi për t'iu dalë në ndihmë fermerëve duke jua kompensuar dëmet. Prej që mbaj mend unë vërshime dhe dëme më të mëdha nga fatkeqësitë natyrore nuk ka pasur në kulturat bujqësore por që tani kushtet klimatike kanë ndryshuar, prandaj edhe kërkoj që të përgatitemi për vitin 2021 dhe të jemi dakord që sa do pak ne të kemi edhe mjetet tona buxhetore për t'iu dalë në ndihmë fermerëve dhe t'i orientojmë aty ku është nevoja.

Nga dita e hënë unë me këto dy qëndrime do të shkoj në MBPZHR, nëse është nevoja edhe në Qeveri do të shkoj për këtë çështje sepse jam shumë i prekur nga kjo situatë.

Edhe në fillim e thash që marr dhe dëshiroj këshilla nga ju, edhe pse me datën 22 dhjetor 2019 kam doktorruar në fushën e bujqësisë mirëpo ende kërkoj këshilla nga ju për çka do që e shihni të nevojshme dhe e domosdoshme tu ndihmohet qytetarëve dhe fermerëve të Podujevës, e mbi të gjitha fermerëve që janë shtresë e veçantë, andaj kërkoj nga ju që të kemi mirëkuptim dhe t'i ndihmojmë

në mënyrën më të mirë të mundshme. Këto dy pika i nderuari Kryesues i Kuvendit mendoj që kishin me qenë dy pikat më të mira që ne të dalim prej kësaj seance.

z.Pajtim Balaj, theksoi, ne përkundër që e propozuam një deklaratë treguam gatishmëri të diskutojmë edhe me përfaqësuesit e subjekteve tjera dhe të gjejmë një zgjidhje përmes një harmonizimi të ideve qoftë të këshilltarëve nga LDK qoftë nga ata të PDK-së, por më vie keq që LDK-ja po refuzon dhe po heziton që të jetë pjesë e një zgjidhje të cilën besoj që duhet ta nxjerrë ky Kuvend ose ne refuzojmë me gjet një zgjidhje dhe themi se këtë punë po ia lëmë Qeverisë, atëherë ne e kemi zhvlerësuar rolin tonë si përfaqësues që kemi marrë votë prej qytetarëve e që mendoj se kjo nuk ka kuptim siç nuk ka kuptim thirrja e vazhdueshme për depolitizim të organit më politik siç është Kuvendi, prandaj ne në harmonizim me këshilltarët e opozitës të subjekteve tjera erdhëm në përfundim që të bëjmë një ndryshim në deklaratë. Duke shtuar si pikë të veçantë krijimin e një komisioni i cili do të përfshinte edhe këshilltar komunal të subjekteve politike për vlerësimin e dëmeve dhe shpërndarjen e subvencioneve ose ndihmave që bëhen, prandaj si të tillë kërkojmë që ta fusim në votim menjëherë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së i propozojmë këtij Kuvendi dy pikat që i propozoj drejtori i DBPZHR z.Vezir Januzi sepse fundja ky është i thirrur më së shumti për temën për të cilën jemi mbledhur sot.

Sa i përket kualifikimeve që i bëri kolegu parafolës, nuk do të merrem me atë çështje sepse është çështje e tij dhe se ne po e shohim që prej fillimi deri në fund tema ka devijuar dhe i kemi marrë më shumë se dy orë duke diskutuar për këtë temë. Për fund dy propozimet paraprake të drejtorit të DBPZHR ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së mendojmë që duhet të kalojnë dhe i propozojmë për miratim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi dy propozime të cilat i potencoj drejtori z.Vezir Januzi dhe që u bë thirrje nga parafolësi që të përkrahen, fjala është që të gjitha dëmet të adresohen në Ministri për kompensimin e tyre, dhe tjetra ishte që në buxhetin e vitit 2021 të planifikohet buxhet për kompensim të dëmeve si subvencione, andaj me këtë e përfundoj debatin dhe njëkohësisht e hedh në votim.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, në formë të konkluzionit përkrahen propozimet e Drejtorit të DBPZHR, dhe atë që,
1-Të gjitha dëmet e shkaktuara të adresohen në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të kompensimit të tyre.
2-Në buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2021 do të planifikohet buxhet për kompensimin e dëmeve, në formë të subvencioneve.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0039155/20

Podujevë,

24 korrik 2020

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi